

*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.13.06.2023*

13.06.2023
Ora 18.02

RENDI I DITËS

Për shqyrtimin në themel të kërkesave ankimore numër 67 dhe 74, të subjektit ankues “Bashkë Fitojmë” si dhe të ankuesit, kandidatit për kryetar të Bashkisë Kuçovë, zotit Lefter Maliqi”

PJESËMARRJA:

- **KAS:** Z. Elvin Lako, Z. Elvis Çefa, Z. Ilirjan Rusmaili,
Z. Koli Bele, Z. Ledio Braho.
- **Stafi KQZ-së:** Z. Ylli Merkaj, Znj. I. Osmanaj, Z. E. Meta.
- **Parti Politike:** PS: M. Legisi, BF: A. Llangozi, L. Maliqi, O. Serani
- **Të tjerë:** **KRIIK**

Z. K. Bele: Riçelim seancën për shqyrtimin në themel të kërkesave ankimore numër 67 dhe 74, të subjektit ankues “Bashkë Fitojmë”, si dhe të ankuesit, kandidatit për kryetar të Bashkisë Kuçovë, zotit Lefter Maliqi. Verifikojmë pjesëmarrjen e palëve. KAS-i është në përbërje të plotë, gjithashtu administrata e KQZ-së me sekretarinë Përgjithshëm, si dhe verifikojmë për subjektin ankues janë avokatët prezent:

Z. A. Llangozi: Ardian Llangozi.

Znj. O. Serani: Orgesa Serani.

*Zbardhi materialin audio
Mirgjina LEKAJ*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.13.06.2023*

Z. L. Maliqi: Lefter Maliqi.

Z. M. Legisi: Marengen Legisi.

Z. K. Bele: Avokati përfaqësues i subjektit “Bashkë Fitojmë” nuk konstatohet prezent. Pavarësisht nga kjo seanca vazhdon. Në këtë fazë relatojmë se në seancën e fundit është kërkuar shtyrja nga ana e avokatëve të anqesit lidhur me paraqitjen e konkluzioneve për ditën e sotme në këtë orar të dakordësuar. Në këtë fazë të procesit i ftojmë palët të ecin me parashtrimet e tyre.

Z. L. Maliqi: Të nderuar anëtarë të KAS-it, përfaqësues të KQZ-së, meqenëse bëra 19 vjet në politikë dhe nuk po arrij të dalloj në Kuçovë ka ndodhur vjedhje apo zgjedhje, besoj se ju do të na jepni një përgjigje. Dhe meqenëse dje miku i përbashkët i juaji dhe i imi, Rusmali, më dha një sfidë, socialisti besoj se po na ndjek për të demaskuar këtë krim të rëndë elektoral dhe kërkon demokraci, aty poshtë derës më kishte lënë dhe këtë dhe jam gati, -më tha, -që t’i bie dhe ato të tjerat. Nuk e di këto dy procesverbale origjinale janë në çdo kuti, apo nuk janë dhe e dyta këtu është me tri firma kurse ajo e djeshmja ishte me katër firma. Kështu që kjo që ka ndodhur në një procesverbal mund të ketë ndodhur në shumë, sipas informacionit që ne kemi nga përplasja që patëm, edhe tensioni i lartë që patëm në KZAZ-në e famshme, me derë burgu dhe me dollap kashte të lidhur me shkollën e mesme, kështu që nuk e di ç’, mund të them. 1000 e disa prova nëpër qendrat e votimit, shkelje të rënda, braktisje të KZAZ-së, oligarkë e të tjera. Nuk dua t’i besoj fjalëve që janë hapur në Kuçovë që leku mposht drejtësinë. Salillari që është oligarku numër 2 në Shqipëri me një fjalë blen drejtësinë dhe çfarë të them unë. Kështu që unë mendoj se të paktën duhet të ketë drejtësi të paktën për demokracinë, për vendin, për shkollat që unë kam

*Zbardhi materialin audio
Mirgjina LEKAJ*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.13.06.2023*

bërë, që 14 vjeç ushtarak, edhe për shërbimet që i kam bërë vendit kërkoj një drejtësi nga ju se kam një bindje totale për një krim të rëndë shtetëror elektoral me sytë e ligjit. Dhe kam një besim total dhe nuk e di pse nuk duhet të hapen kutitë, nuk e di çfarë ka ndodhur në ato kuti, nuk e di që ato 18 kuti që pamë atje nuk dukeshin, pa llogaritur shkeljet e mëdha që pamë te qendrat e votimit që nuk po i futem kallëzimeve të SPAK-ut fare për çfarë u bë para zgjedhjeve me makinat operacionale me drejtues të Partisë Socialiste, apo të bashkisë, apo oligarkë, kështu që besoj ende që ky proces, ta marrin vesh të gjithë shqiptarët, Lefter Maliqi nuk e vret shumë mendjen për karrigen e kryetarit të bashkisë, sepse ajo karrige do të jetë e qytetarëve. Lefter Maliqi i ka provuar të gjitha, me forcat e vetë, 2 herë deputet dhe detyra të larta në Policinë e Shtetit dhe burgjet apo drejtues vendor në komunën më të madhe, por të zbardhet e vërteta që ta marrin vesh të gjithë shqiptarët, organizmat ndërkombëtare, dhe të gjitha me radhë. Transparencë: nuk ka shkelje në ato kuti, t'i shikojmë njëherë si janë, sa fletë janë të miat; sa fletë të miat ka marrë ai tjetri i Alibeajt; çfarë kanë bërë ata të tavolina 5; çfarë kanë bërë në dy tavolinat e tjera ku nuk janë numëruarit; janë apo nuk janë këto procesverbale brenda, janë apo nuk janë me bojëra të hedhura te fletët e votimit. Çfarë ka ndodhur në të vërtetë? Se çfarë ka ndodhur në qendrat e votimit jua thamë ne, nëse është e ligjshme që trekatër pesë vota me radhë të votojnë në qendrat e votimit, nëse është e ligjshme të marrin fletën e votimit, të dalin jashtë këtë nuk e di këtë e dini ju, por, nëse do të ndodhin në Shqipëri më këto fenomene atëherë të themi që as drejtësia, as demokracia, as shtet ligjor nuk mund të presim këtu. Për të tjerat flet avokati.

Z. O. Serani: Në fakt, në mënyrë të përmbledhur, ne kemi pretenduar që procesverbalet origjinale nuk ndodhen në kuti. Në cilësinë e provës sollëm një video në të cilën dukeshin qartë procesverbalet origjinale. Nga ana juaj u kontestua ky

*Zbardhi materialin audio
Mirgjina LEKAJ*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.13.06.2023*

pretendim i yni, përfaqësuesi që u paraqit ditën e djeshme solli një dosje ku kishte procesverbalin origjinal. Tani ne kemi gjetur një procesverbal origjinal që ka të të njëjtat të dhëna me procesverbalin origjinal që u depozituar ditën e djeshme, nënshkrimet këtu janë 3 atje kanë qenë 4. Tani janë origjinal ky, origjinal ai. Nënshkrim tjetër ky , nënshkrim tjetër ai, kush është origjinali nga këta dhe cila është kopja që është bërë në kuti? Se si ka mundësi dy origjinale me përmbajtje të ndryshme , me firmë me vulë, ne nuk e kuptojmë këtë pjesë, prandaj e kemi sjell ën cilësinë e provës, duke qenë se edhe ditën e djeshme, zoti Rusmali na kërkoi që nëse ne gjejmë një procesverbal në origjinal; ja ku është në origjinal, me firma, me vula, ky procesverbal qarkullon lart e poshtë.

Z. K. Bele: Më falni, ne ditën e djeshme kemi përfunduar shqyrtimin dhe marrjen e provave. Sot jemi te konkluzionet, megjithatë ju keni të drejtën të thoni, të na shpjegoni çfarë jeni duke kërkuar, të bëni parashtrimet që proceduralisht të kuptojmë ku jemi.

Z. A. Llamgozi: Jo, ne jemi duke ju thënë që ditën e djeshme, të gjithë së bashku ju, jeni treguar, duke na hedhur hi syve duke na sjellë një person, i cili ka sjellë procesverbale të falsifikuara që nuk i ka pasur detyrë fare t'i mbante në banesën e vet këto procesverbale, dhe në mënyrën më të çuditshme nga ky komision këto procesverbale administrohen. Ja ku është procesverbali origjinal që erdhi ditën e djeshme me furi nga Kuçova. Ia kanë çuar zotërisë sot dhe e paraqesim para jush. Ky është procesverbali që ishte në video. Kjo është e turpshme dhe kjo është prishje dhe falsifikim të materialeve zgjedhore, ashtu, siç është parashtruar. Ne kemi një kërkesë, para se të kalojmë në konkluzione, kërkesa është që ne për kërkimin që ne kishim ngritur para jush në lidhje me pikën 1 dhe 2 të objektit të ankimit nga ana


*Zbardhi materialin audio
Mirgjina LEKAJ*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.13.06.2023*

juaj është vendosur rrëzimi i këtij anikimi, sepse në thelb, për derisa u rrëzua kërkesa për hapjen e kutive, rrjedhimisht janë rrëzuar pika 1 dhe 2 e objektit të padisë, për këtë rrëzim të këtij kërkitimi, ky është një kërkitim përfundimtar, ne i jemi drejtuar Kolegjit Zgjedhor me kërkesë padi ku kërkojmë shfuqizimin e këtij vendimi dhe pavlefshmërinë absolute, sepse është vendim i paarsyetuar, ndoshta është dhe gabimi i këtij kolegji që ka vijuar këtë proces, ka hapur procedurën për vijimin e këtij procesi pa marrë më parë vendimin e arsyetuar të Kolegjit Zgjedhor. Kolegji Zgjedhor në atë endim ka pasur për të lënë detyra, të cilat, jo vetëm që këto detyra u anashkaluan nga Kolegji, por është nxitim i madh që të mbyllen ato kuti me të vetmen arsye që të favorizohet dhe të jepet një mandat në kundërshtim me ligjin, me dokumente të falsifikuara që i mban kryetari i Partisë Socialiste të Kuçovës në shtëpinë e vet. Nëse është rregull, që këto materiale zgjedhore duhet t'i mbajë kryetari i Partisë Socialiste apo të një partie tjetër, atëherë këtë Kodin Zgjedhor ne duhet ta flakim në kosh të plehrave dhe të gjitha vendimet e tjera duhet t'i nxjerrim jashtë loje dhe të marrim një mendim qoftë të kryetarit të Partisë Socialiste Kuçovë, qoftë të Partisë Socialiste në tërësi. Ne e kemi thënë që në fillim të këtij procesi jemi të depolitizuar, por në rastin aktual ne kemi një provë, e cila është skandaloze: për një kuti dy procesverbale origjinale. Në ditët në vijim ne do të nxjerrim të gjitha procesverbalet origjinale që ndryshojnë nga ato që janë aty. Kërkesa është: ne kërkojmë pezullimin e këtij procesi, pasi referuar nenit 80 pika 2 të Kodit të Procedurave Administrative, nenit 66 të tij, dhe nenit 1 të ligjit nr. 49/2012 dhe nenit 36 të Kodit të Procedurës Civile, ky Kolegj nuk është kompetent aktualisht për të gjykuar këtë çështje deri në momentin që të përfundojë procesi në Kolegjin Zgjedhor. Kërkesën e kemi me shkrim. E paraqesim para jush të firmosur.

*Zbardhi materialin audio
Mirgjinja LEKAJ*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.13.06.2023*

Z. I. Rusmali: Para se të kalojmë të shqyrtimi i kërkesës që u paraqit sot, nisur nga ajo që tha avokatja dhe kandidati, unë do të kërkoja nga kolegët, nëse e gjykoni ju të arsyeshme që ne të riçelim hetimin gjyqësor për të administruar si provë procesverbalin që paraqitet sot, sepse unë e konsideroj të rëndësishëm, përtej diskutimit emocional të avokates, që mesa duket ka keqkuptuar qëndrimin tonë. Ne e morëm shumë seriozisht atë insertin e rrjetit televiziv dhe hetuam thellësisht mbi të dhe, ju lutëm që ju të gjeni procesverbale të tjera, apo jo? Nuk ju sfiduar, ju lutëm dhe nuk ju kontestuar. Ne e morëm me shumë seriozitet gjënë dhe mbajtëm shënime për të gjitha shpjegimet që u dhanë aty. Uroj që ta keni bërë dhe ju këtë gjë, që të keni mbajtur shënime për të gjitha shpjegimet që u dhanë aty, se ishin të rëndësishme. Megjithatë unë ju falënderoj shumë që na keni sjellë atë material dhe, nëse kolegët do ta pranojnë kërkesën time, do të doja që ne të administronim atë si provë, pastaj kalojmë të shqyrtimi kërkesave të tjera, nëse ju jeni dakord.

Z. E. Lako: Unë mendoj se në këtë fazë ne duhet të tërhiqemi pasi kemi nevojë të diskutojmë njëherë. Provën? Po prova është e rëndësishme të futet në proces, pra të konsultuar në vend, duke qenë se ka konsensus, pavarësisht se ne ishim në një moment tjetër procedural, riçelim hetimin administrativ administrojmë dokumentin e sjellë nga ana juaj në cilësinë e provës, i cili nuk ka datë, por si i tillë nuk mund të...

Z. Y. Merkaç: Me sa duket është procesverbali që është shfaqur te video dhe mund ta ketë vetëm ai që ka shfaqur këtë video.

(Diskutime pa mikrofon)

*Zbardhi materialin audio
Mirgjina LEKAJ*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.13.06.2023*

Z. K. Bele: Pra, procesverbal Model 007 KZAZ 64 Kuçovë, dat 14.05.2023, ora 07:00, me këtë pamje dhe ka tri firma dhe unë mendoj se duke qenë para kësaj prove ta shikojnë kolegët dhe nëse kanë pyetje.

Z. A. LLangozi: E di cila është më e tmerrshme, është se ku ai zotëri e ka gjetur vulën që ka vulosur një procesverbal tjetër të falsifikuar që e sjell këtu midis të gjithë këtyre njerëzve dhe na gënjen të gjithë neve, jo vetëm ne si palë, por edhe ju, ju ka gënjyer ditën e djeshme dhe të gjitha ato procesverbale që ai ka sjellë janë në të njëjtën fazë.

Z. K. Bele: Pra, kur thanë na hodhi hi syve e kishit për atë jo për ne.

Z.A. LLangozi: Për të gjithë ne. Ai na hodhi hi syve ne.

Z. K. Bele: Pra, jo ne ju hodhëm hi syve ju?

Z. A. Llangozi: Jo.

Z. L. Maliqi: Unë pyeta anëtarë ish-kryetarë KQZ-je, ish anëtarë të KQZ-së dhe të gjithë më thanë që një procesverbal origjinal futet në kuti. Dhe personi, sekretari, kryetari i KZAZ-së nuk do të mbajë procesverbal origjinal në dosje. Në momentin e që e konstaton e dorëzon pranë KQZ-së. Tani se ku e ka marrë këtë vulë dhe këtë procesverbal ...

Z. K. Bele: A keni nevojë ta këqymi?

*Zbardhi materialin audio
Mirgjind LEKAJ*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.13.06.2023*

Z. A. Llangozi: Nuk kam nevojë po a mund të bëj një pyetje nëse më lejoni?

Z. K. Bele: Po, patjetër.

(Diskutime pa mikrofon)

Z. M. Legisi: Po, rreth provës. A ka procesverbale të tjera ankimuesi apo do të zgjedhë duke i depozituar kështu një nga një ditë për ditë? Sepse nuk është erdhëm dje në dijeni të këtij procesverbali, pra video sipas palës ka ekzistuar edhe më përpara.

Z. K. Bele: A keni përgjigje për pyetjen e palës së interesuar?

Z. L. Maliqi: Po ka disa procesverbale të tjera, se i kanë nxjerrë atje kam parë atë numrin, atë numrin e kanë parë të gjithë, se ka një javë ai, dhe prandaj them që këtu është e dyshuar se vetëm ai procesverbal del në ekran dhe është plotësuar dje pardje, ku e di unë kur e kanë plotësuar.

Z. K. Bele: Ylli, a keni ndonjë mendim për këtë provë që ne e administruam?

Z. Y. Merkaj: Po, është vetëm një procesverbal origjinal, të tjerët janë kopje. Përmbajtja është e njëjtë.

Z. K. Bele: Po merre dhe shikoje.

Z. Y. Merkaj: Po dihet se kam parë, po është ai i videos e kemi parë, sepse në bazë të videos ne morëm origjinalet e tjera. Janë të njëjtat kode, dhe është i njëjti

*Zbardhi materialin audio
Mirgjinë LEKAJ*


*Procesverbal i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.13.06.2023*

procesverbal, përmbajtja është e njëjtë. I njëjti procesverbal është. Këtu bëhet fjalë se janë ndryshuar kodet. Kodet në procesverbal janë të njëjtat, si te ai procesverbal që quhet origjinal, si te ky procesverbal që pretendohet se është origjinal. Po merrni vendim dhe jua sjellim të gjitha ne.

Z. K. Bele: Po na i sillni të gjitha ato që shqyrtuam ne.

Z. Y. Merkaj : Po të gjitha, 64 65.

Z. I. Rusmali: Ylli të lutem, ky është procesverbal origjinal apo jo?

Z. Y. Merkaj: Nuk e, di ta shohim.

Z. I. Rusmali: Është në letër nuk është në letër karboni. Ai tjetri ishte në letër, nuk ishte në letër karboni.

Z. Y. Merkaj: Do të thotë ne ju shpjeguar si është, por nuk e dëgjuat.

Z. I. Rusmali: Po, pra por na e shpjegoni prapë.

Z. Y. Merkaj: Po, pra do t'jua shpjegojë drejtori. Nuk e kuptuat, ose nuk e shpjeguar ne mirë.

Z. E. Meta: Atëherë, lidhur me procesverbalin 7 dhe 8 kemi dy sete dokumentesh. Seti i parë i dokumentit është me kopje kimike, pra është procesverbalin 7 me tri kopje kimike, fleta kimike dhe njëjta gjë edhe për procesverbalin 8. Ndërkohë seti i dytë

*Zbardhi materialin audio
Mirgjina LEKAJ*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.13.06.2023*

i dokumentacioni është i printuar me ngjyra, që iu shpërndajmë qendrave të votimit në 4 ose 5 kopje për çdo qendër votimi që shërben si kopje e dytë për t'ua dhënë palëve, pra komisionerëve apo vëzhguesve të partive politike.

Z. I. Rusmali: Pa kopje karboni?

Z. E. Meta: Po është e njëjta me ngjyrë.

Z. I. Rusmali: Pra, pa kopje karboni?

Z. E. Meta: Pa kopje karboni.

Z. K. Bele: Nëse ju kuptova drejt dhe ju mund të më plotësoni, si punë e këtij dokumenti që nuk ka ekstremitete, por është dokument, kjo në një qendër votimi, si puna e këtij shkon 1 apo më shumë se një letër dokument?

Z. E. Meta: Kopje të tilla të printuara shkojnë më shumë se 1 shkojnë 4 ose 5 kopje në varësi të përfundimit që kanë bërë bazën materiale në Lundër dhe set me kopje kimike shkon 1.

Z. Y. Merkaj: Ne kishim në dosje disa dokumente që tregonin se nuk ishin origjinale, por kishin të njëjtën ngjyrë si dokumenti origjinal. Për këtë e kërkuam fjalën, nuk na e dhatë, na e ndërpretë, prandaj dhe ne po insistojmë.

Z. K. Bele: Na vjen keq që ju kemi ndërprerë, siç duket për shkak të seancës së gjatë dhe mund të ketë pasur ndërprerje, por t'ju lutesh, do të kërkoja, jo do t'ju lutesha

*Zbardhi materiqlin audio
Mirgjina LEKAJ*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.13.06.2023*

se nuk është me të lutur kjo punë por e them në termat e edukatës, të sjellim edhe një herë atë kopje të verifikojmë ne në pamje të parë, nëse janë të njëjtat kode. Ndërkaq nëse ka ndonjë pyetje nga kolegët?

Dikskutime

Znj. O. Serani: Sa kopje origjinale plotësohen?

Z. Y. Merkaj: Një!

Znj. O. Serani: Po këtu ajnë dy origjinalë për të njëjtën kuti.

Z. I. Rusmali: Ka keqkuptim në terma, këta kopje origjinale quajnë vetëm atë që është set, ka një fletë letër dhe tri kopje karboni. Kjo quhet origjinale për ta. Kjo që është letër tek origjinalja është identike që është letër letër, por nuk ka kopje karboni, në formë në ngjyrë në të gjitha. Pra, origjinali dhe dallojnë vetëm për shkak se shoqërohet me kopje karboni e quajnë origjinal këta, ne q ëjemi populli origjinal quajmë atë që është letër dhe jo kopje karboni. Pra, duhet ta pajtojmë kuptimin tonë me kuptimin e drejtorit. Se nuk po merremi vesh.

Z. Y. Merkaj: A mund ta shpjegoj? Kopja që është me karbon është kopje origjinale dhe ka tri kopje të tjera. Ne kemi 7 anëtarë të KZAZ-së kemi 10 përfaqësues subjektsh të partive politike që kërkojnë të njëjtin procesverbal dhe duke qenë se janë vetëm 4, origjinali futet në kuti dhe të tjera shpërndahen, prandaj printon KZAZ-ja

Z. E. Lako: Dhe, meqenëse nuk kanë kopje përgjithësisht, ju çoni atë që është

*Zbardhi materialin audio
Mirgjina LEKAJ*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.13.06.2023*

Z. Y. Merkaj: Po, ky është konkluzioni.

Z. E. Çefa: Edhe një pyetje, ju lutem, për administratën, atëherë besoj me këtë shpjegimin tuaj e ka edhe një shpjegim logjik edhe fakti që te kjo kopje janë tri firma te kopja tjetër, i njëjti procesverbal janë 4 firma. A ka një shpjegim logjik kjo?

Z. Y. Merkaj: Ka një shpjegim logjik numrat e kodeve janë të njëjta në të gjitha, vula është e njëjtë, tani se janë tri ose katër ta shohim.

(Diskutime pa mikrofon)

Sepse firmat janë origjinale, firmat që hidhen janë firma origjinale.

Z. E. Çefa: Ju kuptoj krejtësisht, por doja të shpjegoja si ka ndodhur që këtu janë vetëm 3 aty janë 4.

Z. Y. Merkaj: Nuk e di a janë 3 apo 4.

Z. L. Braho: Kam një pyetje për administratën: Këtu është vendosur vula që mban sekretari, se vula në qendrën e votimit është vula e sekretarit, mund të vendosë vulë sekretari kur ka tri firma këtu, apo nuk ka ndonjë problem ai ngaqë ka vulën mund të bëjë...?

Z. E. Lako: Ai ka lëshuar 10-15 kopje atje. E gjithë vëmendja përqendrohet te vendosja e numrit të kodeve.

Z. L. Braho: Pra, nëse numrat e kodeve përputhen

*Zbardhi materialin audio
Mirgjina LEKAJ*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.13.06.2023*

Z. E. Meta: Është sekretari që vendos vulën. Dhe kjo mund të zgjasë gjysmë ore.

Z. L. Maliqi: Problemi qëndron se kush ndodhet nga ato në kuti, cila është ajo që ndodhet në kuti? Pra, cila është e vërteta? Më duket i mban Shushari në shtëpi ato, se atje i mban. Më thoni ju, të nderuar, se ku ishte KQZ-ja që s'kishte dokumentacionin, se e mbante një person në shtëpi dhe duhet t'i besojmë atij zotërisë ne; është e tmerrshme.

Z. A. Llangozi: Se ai tha kam disa procesverbale të tilla, edhe ato i duam ne, kurse këto kodet edhe i kanë ndërruar ata...

Z. I. Rusmali: Avokat, neve nuk jemi këtu për të besuar, ne jemi këtu për të provuar, kështu që rri i qetë për këtë punë. Gjërat që ju i provoni ne i respektojmë, gjërat që pala tjetër i provon ne i respektojmë. Ne provat do t'i shohim që të gjitha në kompleksitetin e vet dhe nuk do të lemë ujë të rrjedhë nga provat. Kështu që mos u mërzit për këtë gjë, e kemi marrë me shumë kujdes dhe me shumë qetësi shqyrtimin e kësaj çështjeje, kështu që nuk ka nevojë fare të emocionoheni. Bëni analizën e provës, thoni gjithçka që keni nevojë të thoni në raport me provën, që mos t'ju ngelet gjë merak dhe kursejini komentet, se nuk ju hyjnë në punë, nuk ju ndihmojmë për asgjë.

Znj: O. Serani: Përveç kësaj e di ç'na duket e çuditshme edhe diçka tjetër, ne sollëm një video që një person nuk voton fare, merr fletën dhe largohet bashkë me fletën. Si ka mundësi që përkon numri i personave që kanë shkuar për të votuar me fletët e

Zbardhi materialin audio

Mirgjinë LEKAJ



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.13.06.2023*

votimit? Nga doli kjo fleta e këtij personi aty brenda në kuti, kur ky e mori dhe se hodhi fare aty brenda?

Z. I. Rusmali: Po këtë s'e keni verifikuar

Znj. O. Serani: S'e kemi verifikuar.

Z. I. Rusmali: Ne verifikuam një qendër tjetër votimi jo atë. Qendra e votimit ku ajo gruaja votonte me 2 vota, e mban mend, aty verifikuam tabelën, këtë do ta verifikojmë se s'bën se nuk e lemë dot. Ju keni paraqitur këtë provë dhe këtë provë ne do ta analizojmë në kontekstin e vet. Ta bëni ju këtë është gjë shumë e mirë paraprakisht. Ta merrni ju tabelën e asaj qendre votimi dhe të thoni ne gjejmë këtë diskordancë që nuk ka kuptim, është gjë e mirë shumë dhe na ndihmon, po ne s'e kemi bërë, ju se keni bërë apo jo? Jo, të lutem, këtë jo, në qoftë se e keni gati në pretendimet përfundimtare, ne do ju dëgjojmë me shumë vëmendje, po deri tani nuk e keni bërë, të themi të vërtetën. E bëme për qendrën tjetër të votimit ku ishte ajo gruaja që kishte votuar, sipas jush, 2 herë për këshillin.

Z. K. Bele: Për të ndihmuar kuptueshmërinë tonë na sillet nga ana e administratës dokumentacion, të cilin mund ta këqyrni edhe, ju për qendrën e votimit 34-17-00, ku procesverbali 07, pra është qendra ta verifikoj 34-17-00 procesverbali 07 është po në 2 kopje. Pra, në një qendër votimi, jo kjo që ne po diskutojmë, janë 2 procesverbale. Ju lutem, mund t'i shikoni, pra kemi sërish të njëjtën situatë, që nuk ka lidhje, ku palët kanë firmosur 2 herë dhe këto janë administruar të dyja. E njëjta gjë për qendrën 35-25-01, ku...

(Diskutime pa mikrofon)

Zbardhi materialin audio

Mirgjin LEKAJ



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.13.06.2023*

Z. K. Bele: Pra edhe në një qendër tjetër 35-25-01 kemi 2 procesverbale. Kemi 2 procesverbale me të njëjtën përmbajtje, me të njëjtat kode. Pra, është 35-25-01, ku kemi gjithashtu 2 modele të procesverbalit 07 dhe te një kanë firmosur 1, 2, 3, 4 anëtarë dhe tek tjetra kanë firmosur 1, 2, 3, 4, 5, 6 anëtarë. Ajo që konstatoj në pamje të parë, kodet janë të njëjta në këto 2 kuti, dhe ajo që është e rëndësishme është që procesverbali me *carbon copy* në këtë rast ka 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7 anëtarë. Pra kemi një situatë, ku ne konstatojmë, në pamje të parë, që si ky procesverbal 07 palët firmosin më shumë se një kopje. Ajo që është kopje autoritare, në kuptueshmërinë tonë, është kopja që shkon me kopja karboni dhe ajo që është e rëndësishme janë kodet që verifikojnë integritetin e kutisë. Kjo është situata që ne konstatojmë lidhur me ekzistencën e më shumë se një procesverbali 07. Në një qendër tjetër kemi qendrën 35-16-01 35-16-01 35-16-01, ku janë 3 procesverbale 07. Pra kjo situatë e cila në pamje të parë mund të japë të drejtën e palëve për të pyetur ndodh rëndomë në të gjitha qendrat e votimit mbasi, siç e shpjegoi sekretari i Përgjithshëm, veç kopjes, me kopje karboni që ruhet në kuti, prodhohen kopje ekstra për palët për të mbajtur një kopje të kodeve. Mbase, kjo bindja ime subjektive nuk e di ç'farë mendojnë kolegët, do të ishte e udhës që ne të kishim një set mbase me 10 kopje karboni, që mos të kishim këtë konfuzion në pamje të parë, por kjo është një situatë që ndodh në çdo qendër votimi dhe garancia janë kodet, pra palët kanë firmosur diku 4 diku 5 që janë këto kode. Ndoshta mund të ketë një kopje që s'e kanë firmosur të pestë dhe e ka mbajtur njëri me 2 firma apo 3 firma, por në pamje të parë unë personalisht nuk shoh problem lidhur me integritetin e këtij dokumenti. Pastaj a mund të ishte ky dokument i ndërtuar në forma të tjera, kjo është një pyetje që ngelet për t'u parë në vijim.

*Zbardhi materialin audio
Mirgjina LEKAJ*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve*

Dt.13.06.2023

Z. L. Maliqi: Nga pyetjet që kam bërë nga ana ligjore dhe Kodit Zgjedhor me fjalë është vetëm një procesverbal origjinal, i cili futet në kuti. Mbase kjo ka ndodh në Kuçovë apo me Shusharin që erdhi i bëri këtu, nuk e di që është ky fenomen në të gjithë Shqipërinë që i mbaka procesverbalet origjinale kryetari i KZAZ-së dhe nuk i fut në kuti, apo është në të gjithë Shqipërinë që paskan nja 3-4 procesverbale origjinale, megjithatë edhe këto origjinalet i shikojmë, se mbase numëruesi i PS ja ka dhënë këto si kode si kështu dhe i kanë plotësuar këta. Bashkëpunimi, krimi i organizuar i ka këto punë.

Z. K. Bele: Ne kemi këtë gjendje, u njohëm me dokumentin e sjellë nga ana juaj bëmë edhe një analizë deri këtu. Kolegët kanë ndonjë pyetje? E rileratoj që kodet përputhen për këtë procesverbal me ato të lexuara në seancën e mëparshme. Mbarojmë me provën.

Z. M. Legisi: Dakord, për sa kohë korrespondojnë edhe provat, edhe Kolegji është dakord, nuk është se kemi ndonjë pretendim, duke u bazuar nga shpjegimi që dha sekretari i Përgjithshëm. Faleminderit!

Z. A. Llangozi: Mundet që administrata të na shpjegojë ku është ndryshimi midis 2 procesverbaleve, ai që ndodhet në kuti dhe këtij, çfarë ndryshimi kanë ato?

Z. I. Rusmali: Na e thuaj edhe një herë.

Z. K. Bele: Na e thuaj edhe një herë, të lutem.

Z. I. Rusmali: Me detaje, të lutem.

*Zbardhi materialin audio
Mirgjina LEKAJ*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.13.06.2023*

Z. A. Llangozi: Në pamje të parë ku ndryshojnë? Domethënë çfarë ndryshimi kanë ato, nga këto qenë kemi paraqitur? Dhe pse ai duhet të quhet kopje jo vetën për faktin se ka letër karboni mbas, por në pamje të parë?

Z. I. Rusmali: Është origjinali për këto.

Z. A. Llangozi: Dje na u prezantua si origjinal ai procesverbal apo jo, ai procesverbali i djeshëm që erdhi me vrull nga Kuçova ishte origjinal.

Z. E. Meta: Atëherë, dokumentacioni që i dërgohet nga KQZ –ja në KZAZ dhe KQV –ve për procesverbalin e hapjes dhe të mbylljes sepse ato janë 2 procesverbale të cilat sipas Kodit KQV-ja është e detyruar t’ua japi edhe palëve, pra anëtarëve apo përfaqësuesve të partive politike. KQZ–ja përgatit një set me kopje kimike për procesverbalet 7 dhe 8 dhe kopje të tjera të shumëfishuara, të cilat janë të njëjta në formë dhe në ngjyrë me procesverbalin 7. Pra, janë të njëjta me fletën e parë me saktë.

Z. A. Llangozi: Me pak fjalë janë disa origjinale, apo jo?

Z. I. Rusmali: Jo, atëherë na e shpjego pse ai,

Z. E. Meta: Sepse kopja e parë ose seti me kopje kimike, faqja e parë që është me ngjyrë futet në kutinë e votimit për kryetar bashkie, ndërsa kopjet e tjera që janë në letër kimike futen tek kutia e votimi për këshillin e bashkisë dhe te kutia e materialeve zgjedhore. Ndërsa kopjet e tjera, sepse nuk kemi fotokopje që të

*Zbardhi materialin audio
Mirgjina LEKAJ*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.13.06.2023*

shumëfishohen këto procesverbale, kopjet e tjera plotësohen nga kryetari dhe sekretari dhe u jepen palëve. Në rastin konkret është e rëndësishme përmbajtja, pra kodi korrespondon po ose jo.

Z. L. Maliqi: Atëherë unë të bie dengun nesër, pse kemi marrë fotokopje ne, për shembull? Pjesën më të madhe se s'i kemi mbledhur të gjitha. E kam fjalën komisionerët tanë vetëm fotokopje, s'kanë marrë njeri origjinalet.

Znj. O. Serani: Më fal, janë 5 kopje, thoni ju, plotësohen me shkrim dorë të pesta, janë identike me njëra-tjetrën pa u verifikuar nëse janë apo jo. Unë kam një origjinale, ti ke një origjinale, një origjinale tjetër në kuti, domethënë me shkrim dore, se unë atë gjë që nënshkruhet me shkrim dore quaj origjinal, ma vërteton ti që ajo që është në kuti dhe kjo që kam unë në dorë kanë të njëjtat kode, si ma vërteton?

Z. A. Llangozi: Kush nga këto është në kuti tani, se këtë s'po marrim vesh, se meqenëse janë..

Z. E. Meta: Atë e ka vërtetuar komisioni në momentin që ka firmosur dhe e ka plotësuar e vërteton

Z. A. Llangozi: Po, po në disa raste që janë kundërshtuar nuk ndodhen fare, që janë kundërshtuar edhe me procesverbale, që komisioni dje nuk i pa, edhe ky komision këtu, mori vendim për mbyllje, i kemi ngritur edhe në ankim që mungojnë procesverbalet dhe kodet e kutive. Janë ngritur dhe nuk u hapen këto kuti. Gjithsesi kush na garanton ne që nuk mund të jenë të tilla kopje dhe a lejohet, a ka mundësi për manipulim me kopje të tilla të kodeve, apo jo?

*Zbardhi materialin audio
Mirgjina LEKAJ*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.13.06.2023*

Z. I. Rusmali: Të bëj një ndërhyrje unë, që të korrigojmë atë që tha avokati për çfarë u diskutua dje. Ne morëm në shqyrtim librin e protokollit dje, avokat, dhe na rezultoi që vetëm për 2 kuti mungonte procesverbali në kuti dhe komisioni kishte mbajtur shënim për këto 2 kuti dhe kishte urdhëruar për të dyja kutitë hapjen e materialeve, të kutisë së materialeve zgjedhore. Siç e lexuam ne, mund ta lexoni ju, se dhe ju e dispononi, pra bëhet fjalë vetëm për 2 kuti. Nga ana tjetër, ai zotëria që na erdhi dje, pse për të është origjinale kjo, sepse ai tregoi këtu përpara nesh, që të gjitha këto materiale që ai dispononte ishin materiale që grupet e numërimit, në përfundim të procesit, në vend që t'i rifusnin në kuti, i kishin futur në dosjen e qendrës së votimit? Kjo ishte dëshmia e tij, dëshmia e tij nuk u kontestua nga asnjë, apo e mbaj mend gabim unë? Ai tha nxjerr nga kutia, në vend që të rifuteshin ishin futur në dosje dhe neve na erdhën nga grupet e numërimit me dosjen.

Z. A. Llangozi: Si nuk u kontestua, u kontestua nga ana ime. Domethënë unë gjatë gjithë kohës i kam ngritur pikëpyetje zotërisë, ku i ka mbajtur, si i ka mbajtur, na gënjeu na tha që kemi kasafortë, e ku di unë, se kasaforta duhet të jetë aseti i KQZ-së, a keni çuar ndonjëherë kasafortë? Mund ta pyesim pak sekretarin.

Z. I. Rusmali: Avokat, për ju fakti që bëni pyetje do të thotë kontestim, dakord.

Z. L. Maliqi: Edhe unë e pyeta, dhe më tha vetëm një kopje ka në çdo qendër votimi. E sfidova, pastaj i thashë, në qoftë se ne do ta gjejmë...

Z. I. Rusmali: Këtë e shpjeguar, historinë e kuptimit që ne të tre ose të katërt kemi për kopjen origjinale dhe të kuptimit që administrata zgjedhore ka për kopjen

*Zbardhi materialin audio
Mirgjina LEKAJ*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.13.06.2023*

originale. Besoj se kjo doli qartë nga ky diskutim sot, apo duhet ta vazhdojmë akoma më tutje?

Z. A. Llangozi: Kjo është shumë e rëndë, nga KQZ-ja për arsye, sepse kjo lë shkak për manipulim të të gjithë materialit zgjedhor.

Z. I. Rusmali: Atëherë ka një zgjidhje për këtë punë, që kur të bëni pak më vonë konkluzionet përfundimtare të ndaleni posaçërisht te kjo. Na shpjegoni arsyen pse kjo është shumë e rëndë, lidhjen logjike të kësaj shkelje me prishjen e procesit të votimit atje, që ne të kemi mundësi ta peshojmë dhe të marrim vendim, apo jo?

Z. K. Bele: Mirë në këtë fazë, kemi pyetje të tjera? Përfundojmë marrjen e kësaj prove të sjellë nga pala dhe rikthehemi në momentin procedural në të cilën rifilluam seancën. Jemi përpara situatës, që jemi për konkluzionet tuaja, ndërkaq në këtë moment procedural ju keni sjellë një kërkesë, e cila është e datës 12.06.2023, që ju e lexuat shkurtimisht, ku përfundimisht kërkojmë pezullimin e ankimit të kandidatit për kryetar bashkie të koalicionit “Bashkë Fitojmë” deri në gjykimin e çështjes nga Kolegji Zgjedhor, të çështjes me objekt “Shfuqizimin e mendimit të komisionit të KAS-it për rrëzimin e pikës 1 të ankimeve të sanksioneve, kur është kërkuar hapja e kutive për rinumërim dhe rivlerësim e votave”. Pra, ju keni kërkuar pezullimin e procesit në këtë fazë ku jemi, mbasi ju pretendoni që keni bërë një ankim.

Z. A. Llangozi: Kërkesë-padi, që ne i jemi drejtuar Kolegjit Zgjedhor me kërkesë-padi, ku kërkojmë shfuqizimin e vendimit të ankimeve, shfuqizimin e vendimit tuaj për rrëzimin e hapjes së kutive, domethënë ju keni rrëzuar dje kërkimin tonë për hapje të kutive, domethënë është në pikën 3 të vendimit.

*Zbardhi materialin audio
Mirgjina LEKAJ*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.13.06.2023*

Z. K. Bele: Lidhur me këtë kërkim të palës, ka ndonjë qëndrim nga ana e palës së personit të interesuar?

Z. M. Legisi : Faleminderit, i nderuar! Konstatojmë që kërkesa ankimore e zotit Maliqi është depozituar që me datën 22.05.2023, pra më 22 maj, sot jemi në datën 13 qershor, dhe sigurisht që në vlerësimin tonë është një tejkalim absolutisht i madh i afateve të shqyrtimit të kërkesave ankimore. Kodi i Procedurës Civile njih edhe abuzimin me të drejtat e palës në proces, dhe në rastin konkret ky është shembulli më tipik. KAS-i i ka plotësuar në vlerësimin tonë të gjitha kërkesat e arsyeshme që njih ligji, të palës ankimuese për të marrë prova, për të shqyrtuar etj, etj. E gjithë kjo bisedë apo debat mbi procesverbalet u bë në bazën e një prove, një video, që në vlerësimin tonë nuk duhet të ishte marrë fare në konsideratë, megjithatë KAS-i, le të themi, u tregua zemërgjerë në administrimin e procesverbaleve dhe në vlerësojmë që është një kërkesë abuzive dhe nuk duhet pranuar. E vlerësojmë edhe në lidhje me sjelljen procedurale të ankimuesit tjetër, që është koalicioni që ka kandiduar zoti Maliqi për kryetar bashkie, është seanca e dytë që nuk paraqitet, që nuk përfaqësohet koalicioni, pavarësisht për shkaqe shëndetësore të avokatit dhe e ka lënë mbrojtjen.

Z. K. Bele: Është e drejtë e tyre.

Z. M. Legisi: Jo, dakord, po unë e interpretoj dhe në një mënyrë të tillë, tani rezultati ka dalë dhe është ai që është, ka një diferencë që duke vlerësuar edhe zonën, edhe numrin e votuesve është një diferencë relativisht e madhe. Tani edhe kandidati, në vlerësimin tonë, duhet ta pranojë atë dhe të vazhdojë jetën, sepse kandidati mund të dojë edhe që të mund të kishte pretendime që të ishte te kutia e votimit në çdo votë

*Zbardhi materialin audio
Mirgjina LEKAJ*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.13.06.2023*

që hidhesh. Tani gjithë materiali zgjedhor nuk referon asnjë lloj shkelje të pretenduar nga ankuesi. Sigurisht, është kërkesë abuzive, nuk lejohet e drejta e ankimit dhe kjo trupë e ka sqaruar në seancat e mëparshme. Ky është rasti i parë faktikisht që ndodh, nuk ka ndodhur ndonjëherë në eksperiencën time. Ne kërkojmë që kërkesa të mos pranohet dhe të rrëzohet si e pabazuar në ligj dhe në prova. Faleminderit!

Z. A. Llangozi: Mundem të bëj pak debat.

Z. K. Bele: Ta dëgjojmë, se ju mbajtet qëndrim, ai mbajti qëndrim, të dëgjojmë KQZ –në lidhur me kërkesën tuaj, nëse keni ndonjë gjë për ta shtuar, mund ta shtoni, meqë do të respektojmë radhën procedurale.

Z. Y. Merkaç: Po edhe ne mendojmë që në fillim të procesit kërkesat e përfaqësuesve të ankuesit kanë qenë kërkesa abuzive, po abuzojnë të drejtën, duke kërkuar shtyrjen pafundësisht të procesit. Kodi Zgjedhor ka parashikuar disa afate prekluzive, brenda të cilit duhet të mbarojë procesi, në të kundërt, ne hyjmë në një amulli që nuk mbaron kurrë, i bie të mbarojmë kur të mbarojë mandati i deputetit. Mendoj që janë kërkesa abuzive, nuk duhet të pranohen dhe duhet të rrëzohen. Për besueshmërinë që kërkojnë dhe çfarë besueshmërie ka, mund të them që Kodi Zgjedhor është kod procedurash, i cili ka një parim tijn baraspeshën politike dhe krijimin e KZAZ-ve dhe QV-ve. Kanë pasur anëtarë në komisionet e qendrave të votimit, kanë pasur anëtarë në KZAZ, nuk kanë lënë asnjë gjurmë që në marrjen në dorëzim të dokumenteve

Z. K. Bele: Këtu jemi te themeli, Ylli.

*Zbardhi materiaqin audio
Mirgjina LEKAJ*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.13.06.2023*

Z. Y. Merkaç: Kështu që kjo kërkesë është abuzive dhe kërkoj të rrëzohet.

Z. K. Bele: Keni gjë për të shtuar, avokat?

Z. A. Llangozi: Edhe një herë se ndoshta po bëhet pak probleme kjo punë. Në qoftë se ky institucion është një institucion ku duhet të noterizohen vendime kriminale të disa punonjësve, atëherë ju mund të vazhdoni, ju edhe pa prezencën tonë mund të merrni vendime, e keni thënë edhe më parë, nëse kanë të drejtë apo jo, edhe nëse unë kam pasur të drejtë apo jo, e ka vendosur një institucion më i lartë, nuk e ka vendosur as Kolegji Zgjedhor, as kjo trupë gjyquese, e ka vendosur Kolegji Zgjedhor duke më dhënë të drejtë në të njëjtën situatë, identike si ky rast, sepse ju më keni rrëzuar kërkimin kryesor dhe unë ,kur ngre një kërkim, duhet të marr një përgjigje me vendim përfundimtar mbasi të ketë kaluar të drejtën e bërjes së provave kontradiktore dhe jo me vendim të ndërmjetëm, të më merret një vendim duke marrë një vendim përfundimtar për një vendim të ndërmjetëm. Pra, ju jo vetëm keni paragjykuar zgjidhjen e pavlefshmërisë absolute, por me vendimin që ju keni marrë ditën e djeshme, më keni cenuar në mënyrë të drejtpërdrejtë të drejtën e marrjes dhe aksesit në sistemin e drejtësisë. Nuk është më e rëndësishme se kryetari i bashkisë do kurorëzohet ditën e sotme apo mbas dy ditësh, është e rëndësishme që ne të marrim një vendim të drejtë dhe vendimi i drejtë është vetëm kur kontrollohet nga gjykatat më të larta. Edhe nëse unë kam bërë një kërkim abuziv apo jo, është ai institucion që do ta vendosë, ashtu siç vendosi herën e parë, se u pretendua edhe nga KQZ-ja, ashtu edhe nga pala e interesuar, Partia Socialiste, që kërkitimi im ishte abuziv. Por jo, nuk rezultoi kështu. Jemi përpara të njëjtave fakte që dy pikat e objektit të kërimit tim më janë rrëzuar, pavarësisht se nga ana juaj i vihet një numër vendimit apo jo, unë kam një vendim për kërkimin që unë kam parashtruar përpara

*Zbardhi materialin audio
Mirgjina LEKAJ*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.13.06.2023*

këtij kolegji, për këtë arsye është ai institucion. Nuk është se unë po kërkoj shtyrje, jo, unë nuk kërkoj shtyrje, unë kërkoj pezullim...


Z. K. Bele: Ju i qëndroni...

Z. A. Llangozi: Do ta shpjegoj edhe shkakun pse kërkoj pezullim.

Z. K. Bele: Pra, keni argumente shtesë në mbështetje të...

Z. A. Llangozi: Po shpjegoj kërkesën. I referohem nenit 90 të Kodit të Procedurave Administrative. Nëse ju keni marrë një vendim tashmë për rrëzimin e dy pikave të kërimit tim, në pikën 1 të kësaj dispozite ligjore, ju nuk keni detyrim më për të shqyrtuar këto. Ky është një kërkim përfundimtar tashmë dhe unë, bazuar në nenin 80, pika 2, dhe ligjin për gjykatat administrative, nenin 1, dhe Kodin e Procedurave Civile unë e vlerësoj si një vendim përfundimtar, sepse në nenin 40 të Kodit të Procedurave Administrative është e përcaktuar se cilat janë vendimet përfundimtare dhe vendimet jopërfundimtare. Në nenin 40 kërkesa për rrëzim është një vendim përfundimtar dhe është e përcaktuar qartë dhe përfundimin e një procesi e vendos kërkesa ime, unë e kam bërë kërkesën në objekt dhe për atë objekt kërkitimi unë kam marrë rrëzim. Për këto arsye unë i jam drejtuar asaj gjykate, ashtu siç iu drejtova për rastin e parë, që Kolegji më dha të drejtë. Në lidhje me pikën tjetër të vendimeve që ju mund ta quani vendim të ndërmjetëm, nuk kemi: kemi tre lloj vendimesh: vendim të ndërmjetëm, vendim përfundimtar, vendim jopërfundimtar. Vendimet e ndërmjetme ndahen në dy kategori: vendim i ndërmjetëm, i cili arsyetohet dhe vendimi i ndërmjetëm që nuk arsyetohet. Në rastin konkret, edhe referuar nenit 126 të Kodit të Procedurës Civile, ky është një vendim përfundimtar, sepse është një

*Zbardhi materialin audio
Mirgjina LEKA*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.13.06.2023*

vendim që zgjidh çështjen në themel, gjë që ju e keni zgjidhur se më keni rrëzuar. Jo, unë kam marr kërkim rrëzim ashtu siç ishte herën e parë. Të njëjtën gjë pretenduat ju, më thatë që nuk ke të drejtë, ama kisha të drejtë, jemi përpara të njëjtit fakt. Ju e keni detyrim të mos vijoni këtë proces. Ju mund të bëni si të doni, por referuar nenit 36 të Kodit të Procedurës Civile, kur një çështje gjykohet nga një gjykatë, ju nuk mund të vijoni shqyrtimin e këtij procesi. Ju mund të bëni si të doni, por...


Z. M. Legisi: Premisa është e gabuar për mendimin tonë, sepse në rastin e parë KAS-i nuk i mori fare në shqyrtim në themel pretendimet e palës. Në rastin konkret pala ka bërë pretendime, ka marrë prova etj., etj., dhe u vendos rrëzimi. Pra, nuk jemi në të njëjtat kushte.

Z. A. Llangozi: Ku e dimë se çfarë do të vendosë Kolegji se ditën e nesërme kemi seancën. Në qoftë se është më e rëndësishme pritja e një vendimi sesa dhënia e një mandati në kundërshtim me ligjin, është e drejta juaj.

Z. K. Bele: Ju keni bërë një kërkim që e sollët në seancë si kërkim, që e quani paraprak, megjithatë nuk po shprehem nëse ishte momenti procedural. Ne do të tërhiqemi nëse nuk ka pyetje të tjera. Ka pyetje?

Z. I. Rusmali: Ka një gjë që është shumë e thjeshtë, se po ngatërrohem. Ata kanë bërë një seancë tjetër, ne kemi bërë një seancë tjetër. I nderuar avokat, në seancën e kaluar kërrove të merreshin prova. Provat merren me vendim të ndërmjetëm, rrëzohen me vendim të ndërmjetëm. Prova, i dashur, jo që të vendosej lidhur me objektin e ankimit. Kërrove marrjen e provave. Në qoftë se nuk ka në seancë vendime në raport me marrjen e provave, seanca nuk mbyllet kurrë, është *perpetum*,

*Zbardhi materialin audio
Mirgjina LEKAJ*




*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.13.06.2023*

se duhet të mbyllim marrjen e provave, që të shkojmë te pretendimet përfundimtare, që të shkojmë te vendimi përfundimtar, që të arsyetojmë vendimin tonë për rrëzimin e kërkesës për marrjen e provave. Procedura e shkruar e gjitha te Kodi Zgjedhor. Kështu që mos na fut në histori që nuk kanë sens me shpjegime që nuk kanë lidhje me seancën. Në qoftë se ke për të shtuar në raport me kërkesën për pezullim, pra, jo me analizën çfarë më rrëzuar e çfarë nuk më rrëzuar, në raport me kërkesën për pezullim, përveç asaj që na the që Kodi i Procedurave Civile nuk na lejon ne të vazhdojmë me shqyrtimin, sa kohë që ti ke bërë një kërkesë padi, na lejo të marrim vendimin, ta mbyllim këtu debatin. Ke gjë për të shtuar?

Z. A. Llangozi: Unë kam për të shtuar, se në lidhje me atë që ju më parashtruat, se ju keni marrë një vendim, ashtu siç po ma shpjegoni, kjo nuk është çështje besimi që unë duhet të besoj te ju, por kjo është një çështje kontrolli të procesit dhe unë kontrollin e procesit e bëj vetëm nëpërmjet asaj që unë kam vepruar, drejtimin në një institucion më të lartë që ju kontrollon ju. Ju më thoni që ky është një vendim i ndërmjetëm. Unë them që ky është një vendim përfundimtar, është dikush tjetër që ligjvënësi e ka përcaktuar, që do ta ndajë, është vendim i ndërmjetëm ose përfundimtar. Unë asnjëherë nuk jam bërë pjesë as e zvarritjes së procesit. Kam marr pjesë, kam dy javë edhe unë që po rri me ju për të mirën e zhvillimit të këtij procesi, nuk kam ardhur këtu as të zvarris procesin e asgjë. Ajo shtyrje, nuk po them që jeni ju fajtorë, është kjo çështje mendimi, edhe unë kështu mendoj, ama mendimi im në rastin e parë që është identik si ky rast...

Z. K. Bele: Avokat, dakord, ju keni bërë kërkimin tuaj...

*Zbardhi materialin audio
Mirgjina LEKAJ*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.13.06.2023*

Z. A. Llangozi: Për këtë arsye unë kërkoj pezullim, sepse në moment që unë kërkoj pezullim, ndihmohet procesi dhe është i pezulluar afati 10-ditor që avokati pretendoi, prandaj kërkohet pezullim në këtë proces.

Z. K. Bele: Faleminderit! Në këtë fazë, meqenëse nuk kemi pyetje të tjera, KAS-i tërhiqet për vendim. Lidhur me këtë kërkim tuajin, do t'ju thërrasim shpejt në varësi të debatit tonë. Ju lutem na prisni deri sa të diskutojmë për këtë moment procedural.

Rifillon seanca

Ora 19:12

Z. K. Bele: Riçelim seancën. KAS-i i konsultuar lidhur me kërkesën tuaj, datë 12.6.2023 për pezullimin e procesit, vendosi që lidhur me këtë kërkim, në mbështetje të nenit 124 dhe vijues të Kodit Zgjedhor, si dhe nenit 66 e vijues të Kodit të Procedurave Administrative, kjo kërkesë rrëzohet. Sqarojmë se kërkesa për marrjen e provave sipas nenit 136/4 të Kodit Zgjedhor, e bërë në ditën e djeshme, është një kërkesë që do të arsyetohet bashkë me vendimin përfundimtar dhe ndaj kësaj kërkesë në këtë fazë nuk ka shkak ligjor për të kërkuar pezullimin. Duke qenë se kemi këtë vendim të KAS-it dhe procesi vazhdon atje në pikën ku ne e çelëm, në momentin procedural të marrjes së pretendimeve tuaja përfundimtare lidhur me procesin, ftojme palët. Fillimisht palën ankuese lidhur me kërkimin përfundimtar.

Z. A. Llangozi: Unë kërkoj përjashtimin e trupit gjykues, sepse trupi gjykues ka marrë rolin e një gjykate tjetër, ka dalë jashtë kompetencave të veta, ka paragjykuar komplet procesin. Unë nuk kam kërkuar marrje prove duke hapur kutitë, por unë kam kërkuar hapjen e kutive dhe numërimin e të gjitha votave dhe njëkohësisht edhe verifikimin e materialit zgjedhor, por hapjen e kutive e kam kërkuar në pikat 1 e 2

*Zbardhi materialin audio
Mirgjina LEKAJ*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.13.06.2023*

të ankimit. Kështu që për këto arsye unë kërkoj përjashtimin e trupit gjykues, sepse ju keni marrë rolin e Kolegjit Zgjedhor. Kërkesën do ta bëj me shkrim, po jua shpjegoj, se mora kohë herën e parë, meqenëse zoti Çefa këmbënguli shumë se ku e bazoj unë afatin 3-ditor...

Z. E. Çefa: Këmbëngul prapë edhe sot, të njëjtën pyetje do të bëj. Edhe bazën ligjore për përjashtimin tonë, ma cito pak nenin, kot.

Z. A. Llangozi: Do ta shpjegoj pra. Në lidhje me shkakun, do ta shkruaj. Në lidhje me bazën ligjore...

Z. E. Çefa: Ju na e thoni një herë me gojë, se keni detyrim të na e relatoni tani se çfarë po kërkon, pastaj do të shohim ne a do të të japim kohë për ta shkruar apo jo.

Z. A. Llangozi: Në lidhje me kërkesën, është një e drejtë ekskluzive imja. Në lidhje me vendimin, është një e drejtë juaja. Atëherë po ta shpjegoj shkurtimisht. Bazuar në Kodin Zgjedhor nuk ekziston përjashtimi. Në momentin kur nuk kemi parashikim në Kodin Zgjedhor, atëherë plotësohet nga Kodi i Procedurave Administrative. Referuar Kodit të Procedurave Administrative nuk kemi sërish përjashtim, pavarësisht se duke filluar nga neni 4 e vijues ju duhet të jeni të paanshëm dhe jo të merrni një vendim për Kolegjin, ky është një shkak, por do ta arsyetoj pse është ky vendim, por, referuar nenit 80, pika 2, të Kodit të Procedurave Administrative, është e përcaktuar qartë që në momentin kur nuk parashikohet një kërkim apo marrja e një prove në këtë dispozitë, atëherë futet në fuqi ligji për gjykatat administrative. Nëse ne i referohemi nenit 1 të ligjit për gjykatat administrative, thotë që në momentin që ligji për gjykatat administrative nuk e plotëson këtë normë që ne po kërkojmë, sepse

*Zbardhi materialin audio
Mirgjina LEKAJ*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.13.06.2023*

flasim për një paanësi, për një kuazi gjykatë, një gjykatë, atëherë i referohemi Kodit të Procedurave Civile dhe ky Kod në nenin 72 i përcakton qartë rastet e përjashtimit të një organi gjyqësor ose trupe gjyqësore.

Z. E. Çefa: Ju thatë që në Kodin Zgjedhor nuk e bazoni dot, se nuk ka bazë ligjore, pastaj as në Kodin Administrativ nuk e bazoni dot se nuk ka bazë ligjore të plotë, pastaj marrim ligjin për gjykatat administrative, edhe aty nuk gjejmë bazë ligjore të qartë, po shkojmë te Kodi i Procedurës Civile, neni 72. E kuptova qartë? Faleminderit!

Z. A. Llangozi: Neni 72. Ju e përdorni Kodin e Procedurës Civile në momentin e marrjes së dëshmive, ashtu siç u pyet edhe zoti Shushari dje, një dëshmitar, të cilit nuk iu bë me dije cilësitë e dëshmitarit, detyrimin për të treguar të vërtetën, betimin përpara gjykatës etj. Kjo është kërkesa ime, të cilën do ta bëj me shkrim.

Z. E. Çefa: Të lutem, edhe bazën ligjore të afatit 3-ditor ose 5-ditor për të pritur ne që ta bëni ju me shkrim.

Z. A. Llangozi: E ka neni 72 i Kodit të Procedurës Civile.

Z. E. Çefa: Mund të ma lexojë dikush?

Znj. O. Serani: Në momentin që shkakun për përjashtim lind në seancë, kemi afat 3-ditor për paraqitjen e...

*Zbardhi materialin audio
Mirgjina LEKAJ*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.13.06.2023*

Z. E. Çefa: Në çfarë seance? Për çfarë seance bën fjalë Kodi i Procedurës Civile ose administrative?

(Diskutim pa mikrofon)

Kuptova.

Z. K. Bele: Unë po lexoj nenin, se edhe ne kuazi gjykatë jemi dhe mbase disa nene të Kodit nuk i kemi parasysh: “Rastet për përjashtimin e gjyqtarit”.


Z. A. Llangozi: Nuk e kemi Kodin.

Z. K. Bele: Mund të keni kopjen e printuar, në qoftë se është e njëjta. Me sa shoh këtu janë 6 raste të përjashtimit të gjyqtarit dhe nuk gjej afat në këto raste. Gjithsesi, po ju dëgjojmë ju, pa paragjykuar se çfarë do të bëni. Keni një kërkesë, ju lutem ta artikulonit, sepse kemi një shkak që lindi në këtë seancë. Artikuloni kërkesën tuaj dhe ne do të shprehemi lidhur me kërkesën.

Z. A. Llangozi: Kërkesën është e drejta ime ta bëj me shkrim, apo jo.

Z. I. Rusmali: Avokat, që të ruhen të gjitha limitet procedurale dhe etike e profesionale për gjithsecilin nga ne, e morëm një vendim si trup, jo Kodi Zgjedhor, jo Kodi i Procedurave Administrative, jo Kodi i Procedurës Civile, por edhe Karta e OKB-së, kundërshtimin e vendimit e kanë vetëm me ankim, jo me përjashtim të trupës, se nuk na pëlqen vendimi. Ndaj vendimit ankoresh, mos u fut në pyll, i dashur, se nuk ka kuptim. E para. E dyta, nuk ke asnjë mundësi, as teorike, të largohesh nga Kodi Zgjedhor me kërkesat çfarëdo qofshin ato për përjashtim, sepse të mungon premisa, i dashur. Kodi Zgjedhor dhe Kodi i Procedurave Administrative e parashikojnë të drejtën për përjashtimin e anëtarëve të trupës, se nuk ekziston e drejta për të kërkuar përjashtimin e trupës, parashikojnë edhe kushtet specifike kur mund të kërkohet përjashtim. Ngado që të shkosh, i dashur, ose do të gjesh kushtet aty te dispozita përkatëse për përjashtimin, dhe do ta mbështesësh kërkesën aty, ose do heshtësh, nuk ka mundësi tjetër. Me akrobaci nuk bëhet dot, prandaj të lutem

*Zbardhi materialin audio
Mirgjina LEKAJ*




*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.13.06.2023*

shumë, në qoftë se ti mendon se gjithçka ne kemi bërë në këtë proces për ta çuar në konkluzion me sukses këtë çështje, gjithçka kemi bërë, nuk duhet të shkëlmohet në këtë formë, por duhet t'i kthehemi seriozitetit të procedurës dhe heq dorë, dakord, e quajmë që iku, kaloi ose përndryshe ne mblidhemi tani dhe e ndajmë këtë punë pa pasur nevojë për të shkuar më tutje dhe ta them, avokat, pse, sepse nuk ka nevojë për paraqitjen me shkrim, kërkesa është abuzive. Ndaj vendimeve ka ankim, nuk ka përjashtim gjyqtari. Përjashtimi i gjyqtarit vjen për shkaqe të tjera, por jo ndaj vendimit. Ne morëm një vendim, të rrëzuar ty një kërkesë. Mund të të vijë hidhur, por ti e di shumë mirë që rrugën e mbrojtjes e ke në Kolegjin Zgjedhor, se e di këtë gjë, dhe do të mbrosh të drejtat e tua në Kolegjin Zgjedhor, por ndaj vendimit tonë nuk reagohet me kërkesë përjashtimi, se nuk është mirë, se jemi edhe juristë.

Z. A. Llangozi: E para, unë nuk është se jam futur në pyll, se unë e marr si kërcënim këtë “mos u fut në pyll”. Thjesht bëra një kërkesë procedurale dhe, meqenëse nuk u gjet baza ligjore fikse, se unë te kërkesa ime thashë 72 e në vijim, në nenin 74, paragrafi i dytë, janë të përcaktuara në mënyrë të qartë rastet ose afatet për bërjen e një kërkesë, që është 3 ditë. Është abuzive apo jo, kjo kërkesë duhet gjykuar dhe jo paragjykuar ashtu siç ju morët vendim individual. Më pëlqen mua, nuk më pëlqen mua një vendim, unë nuk thashë që ju morët një vendim të gabuar dje dhe unë kërkova përjashtimin tuaj sot, por ju morët një vendim, sipas meje, të gabuar ditën e djeshme dhe unë kam bërë një padi ditëm e sotme, që nesër unë kam një gjykim që do ta gjykojë dhe është ajo trup gjykuese që vendos dhe ju me të drejtë e thatë që ju duhet t'i drejtoheni një gjykate më të lartë, dhe faleminderit edhe për atë që na the, që çështjen ti do ta zgjidhësh në Kolegj e jo te ky institucion, e tha pak më përpara. Gjithsesi, unë kur mendoj se ju u tërhoqët për t'u shprehur për Pëllumb Salillarín dhe i morët kohë vetes 3 ditë, ju nuk prisni vendimin e një gjykate...

*Zbardhi materialin audio
Mirgjina LEKAJ*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.13.06.2023*

Z. A. Llangozi: Deri ditën e nesërme? Kjo nuk është negociatë, por është kërkesë të cilën...

Z. K. Bele: Ju dhamë tre ditë që ju të mernit videot që ju kërkuat, nuk ju dhamë...

Z. A. Llangozi: Videot që ne i kërkuam 15 ditë.

Z. K. Bele: Për korrektësi, dakord.

Z. L. Maliqi: Kisha një ndërhyrje të vogël përpara se të tërhiqeshit për vendim. Përfaqësuesi i Partisë Socialiste foli edhe për zëmërgjërësi të madhe, këto janë gjithmonë zëmërgjërë kur ka abuzime, vjedhje, manipulime e të gjitha me rradhë, përfaqësuesi përsëri edhe i Partisë Socialiste por edhe i KQZ-së e patën me afatet kohore. Edhe unë mendoj, mendoj që çfarë të keqe ka këtu, ne për një ditë, dy ditë, hapnim kutitë se këtë po kërkoj unë, unë po kërkoj kërkesën e socialistëve më shumë, se ata më kanë votuar me shumicë në Kuçovë mua, se po të ishte për opozitën, Partinë Demokratike, e dija dhe vet që nuk fitoja, prandaj, çfarë të keqe ka këtu, të hapeshin kutitë, të shikonin çfarë kanë bërë brenda kutive, siç u hapën në qendrat e votimit për të parë e të gjitha me rradhë. Dhe e fundit, unë nuk paragjykojë sepse ju njoh, por do t'iu lutesha shumë nëse ka nga ana juaj vendim politik, jepeni, mos na dëgjoni fare për konkluzionet, të merremi me Kolegjin përfundimisht dhe jemi në rregull.

Z. K. Bele: Bele.Faleminderit, ne kemi një kërkim nga pala që ju e mbështesni, për përjashtimin tonë. Pala ankuese për procedurën nëse keni gjë për të thënë?

*Zbardhi materialin audio
Andoneta GJIKNURI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.13.06.2023*

Z. M. Legisi, përfaqësues i PS-së: Vazhdon me kërkesat abuzive sepse dhe në një rast hipotetik kush do ta gjykonte kërkesën ankimore nëse do përjashtoheshit apo nuk e di, kjo është absolutisht e pakuptimtë, edhe vet procesi zgjedhor dhe mënyra sesi janë parashikuar afatet apo shkallët e ankimit, le të themi është parashikuar që të përfundojë në një afat sa më të shpejtë dhe në këtë kuptim edhe njëfarë kufizimi që i është bërë palës në lidhje edhe me përjashtimin e komplet trupës gjyqësore duhet parë në këtë këndvështrim, faleminderit.

Z. K. Bele: Lidhur me këtë kërkesë tuajën KAS-i do të tërhiqet përsëri duke marrë pak kohë për tu shprehur, ju lutem mos u largoni.

Z. A. Llangozi: Kë kërkesë?

Z. K. Bele: Kërkesën për përjashtim që ju sapo thatë.

Z. A. Llangozi: Unë se kam bërë, kërkoj kohë për ta bërë.

Z. K. Bele: Ju bëtë një kërkesë si dhe kërkuat kohë për ta bërë kërkesën me shkrim. Jam korrekt me relatimin për efekt të procesverbalit audio, dhe procesverbalit

Z. A. Llangozi: Po, ka arsye kërkesa, se s'mund të jetë kërkoj përjashtim, do bërë arsyetim.

Z. K. Bele: Po, avokat. Ju mund të bëni një numër të palimit kërkesash dhe të kërkonti gjithashtu në mënyrë pa limit kohë për të bërë secilën kërkesë. Kjo është e drejta juaj. Në këtë fazë të procesit ne kemi të drejtën që të tërhiqemi, pra të ndërpresim

*Zbardhi materialin audio
Andoneta GJIKNURI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.13.06.2023*

seancën dhe shprehemi për çfarë ju artikulluat dei tani. Kjo është e drejta jonë, dakord? Kështu që ne do tërhiqemi dhe do t'ju thërrasim përsëri. Faleminderit.

Rifillon Mbledhja

Ora 19:33

Z. K. Bele: Mirë riçelim seancën lidhur me kërkesën për përjashtimin e trupës së KAS, vlerësojmë se në tërësi kjo kërkesë është abuzive, është ekstraprocedurale dhe pa bazë ligjore dhe për këtë arsye KAS vendosi rrëzimin e kësaj kërkesë duke vazhduar procesin në pikën ku ishim, në kërkimin e palëve, ose i kërkojmë palëve të paraqesin konkluzionet e tyre përfundimtare për këtë proces.

Z. L. Maliqi: Ndërfaqja e KQZ-së, ky që e kemi akuzuar ne në SPAK e kudo, sekretari i KZAZ-së, shkruan këtu drejtësi funksionon, shikoni duroni se dhe pak çdo gjë do mbaroj. Imagjino çfarë ndodh domethënë, çfarë lidhje vendimesh, shpresoj mos ketë vendim politik domethënë.

Z. K. Bele: Mirë avokat?

Z. A. Llangozi: Po, tani konkluzionet, pikën një dhe dy i eliminojmë apo jo?

Z. K. Bele: Ju paraqisni konkluzionet tuaja për çfarë ka ndodhur në proces, të cilat besoj i keni dhe me shkrim, nëse çmoni t'i lexoni në mënyrë të përmbledhur apo në variantin që ju doni, ne jemi këtu për t'iu dëgjuar dhe të gjitha konkluzionet tuaja do bëhen pjesë e fashikullit dhe do çmohen ashtu siç janë paraqitur, nuk eliminohet asnjë pikë.

*Zbardhi materialin audio
Andoneta GJIKNURI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.13.06.2023*

Z. A. Llangozi: Konkluzionet i kemi me shkrim, gjithësej janë 19 faqe.

Znj. O. Serani: Atëhere ankuesi zoti Lefter Maliqi i është drejtuar komisionit me objekt ndryshimin e vendimit numër 101, datë 16.06.2023, të KZAZ-së numër 64, Bashkia Kuçovë. Pika e dytë e kërkesës ankimore tonë ka qënë rinumërimi dhe rivlerësimi i votave për ZAZ-në numër 64. Pika e tretë, pavlefshmërinë e vendimit numër 101, datë 16.05.2023, pika tjetër, pavlefshmërinë e vendimit të KZAZ-së numër 64, për shtyrjen e numërimit të votës nga ora 11 deri në 12:30, dhe pika e fundit pavlefshmërinë e veprimit juridik, formularin e dekriminalizimit në emër të zotit Kreshnik Hajdari. Në fillim të paraqitjes së kërkesës ankimore ka qënë dhe një pikë tjetër të cilën ne hoqëm dorë gjatë zhvillimit të seancave dhe i qëndrojmë po atij qëndrimi që kemi mbajtur gjatë zhvillimit të seancave. Atëhere së pari pala ankuese ka kërkuar pavlefshmërinë e veprimit juridik, formularin e dekriminalizimit në emër të zotit Kreshnik Hajdari dorëzuar pranë KQZ-së, referuar ligjit numër 138/2015 për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike, ku rezulton se në Bashkinë Kuçovë, ushtron detyrën e Kryetarit të Bashkisë, zoti Kreshnik Hajdari, i cili kandidon dhe në zgjedhjet vendore të datës 14 maj 2023, për Kryetar Bashkie si përfaqësues nga Partia Socialiste. Kryetari i Bashkisë Kuçovë, zoti Kreshnik Hajdari rezulton i dënuar nga drejtësia greke për akuzën e kalimit të paligjshëm të kufirit, fakt ky i padeklaruar në formularin e dekriminalizimit. Emir i zotit Kreshnik Hajdari, që aktualisht drejton në siglën e PS-së Bashkinë e Kuçovës dhe aktualisht është Kryetar Bashkie, ndodhet mes emrave të 18 personave, emigrantë shqipëtarë që janë kapur nga policia greke dhe dënuar nga gjykata e Janinës.

*Zbardhi materialin audio
Andoneta GJIKNURI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.13.06.2023*

Z. A. Llangozi: Fakti i vendimit të dënimit është një provë të cilën ne e kemi depozituar para jush , është një provë e cila është në formën e kërkuar nga ligji, me vulën apustile përkatëse që është vendim penal i formës së prerë, nuk është vendim administrativ, por është vendim penal. Zoti Hajdari ka qënë prezent si në momentin e ndalimit, se e ka pranuar dhe vetë në rrjetin e tij social Facebook ka qënë prezent edhe gjatë hetimit që është bërë kundrejt tij, njëkohësisht ka qënë prezent dhe në momentin e dënimit. Atë e thotë vendimi, është përkthyer nga një përkthyes i liçencuar dhe është në formën e kërkuar, është dhe i noterizuar.

Znj. O. Serani: Vendimi për dënimin e Kryebashkiakut Kreshnik Hajdari është dhënë në vitin 1999 nga një gjyqëtar i vetëm, i Gjykatës Penale të Janinës. Gjyqëtari ka gjetur fajtor dhe dënuar zotin Hajdari me 1500 dhramih, për këtë vendim Kryetari i Bashkisë Kuçovë, zoti Kreshnik Hajdari ka patur dijeni të plotë pasi ka qënë prezent gjatë zhvillimit të gjykimit të kësaj çështje. Gjithashtu edhe në një status sqarues sipas tij, për këtë fakt, në llogarinë e tij Facebook

Z. A. Llangozi: Sqarojmë pikën e dënimit, është dënuar me 1500 dhramih pasi është dënuar me katër muaj burgim dhe më pas në konvertim të këtij dënimi është dënuar me gjobë 1500 dhramih.

Znj. O. Serani: Në formularin e vetëdeklarimit që ai vetë ka dorëzuar pyetjes standarte që nëse ai kishte qënë nën hetim apo gjykim nga një autoritet i huaj, i është përgjigjur në kuadratin, jo, fakt ky i pavërtetë dhe e bën formularin e pastërtisë së figurës të fallcifikuar. Me Jo, Hajdari i është përgjigjur dhe pyetjes numër 2 në formular, ku i kërkohet të deklaroj nëse është i dënuar ose jo, nga një autoritet i drejtësisë shqipëtare dhe të huaj, fakt ky i pavërtetë, pasi e vërteta është krejt

*Zbardhi materialin audio
Andoneta GJIKNURI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.13.06.2023*

ndryshe, zoti Hajdari rezulton i dënuar. Me Jo i është përgjigjur dhe pyetjes tjetër, nëse ka qënë i ndaluar nga organet ligjzbatuese për kryerjen e ndonjë vepre penale, zoti Kreshnik Hajdari i është përgjigjur me Jo, ndërkohë ndodhet me 18 emrave të personave emigrantë shqipëtarë që janë kapur nga policia greke dhe dënuar nga Gjykata e Janinës. Nëse i referilohemi ligjit 138 të 2015-ës, për garantimin e integritetit të personave që zgjidhe, emërohen ose ushtrojnë funksione publike, në nenin 5 pika 1, personat e parashikuar nga neni 2 dhe 3 të këtij ligji, duhet të plotësojnë dhe të nënshkruajnë një formular vetëdeklarimi me anë të të cilit të deklarojnë mosegzistencën e shkaqeve për të kandiduar, për të mos u zgjedhur ose emëruar. Deklarimi i rrethanave të rreme ose të shtrëmbëruara përbën vepër penale sipas nenit 190 të Kodit Penal, parashikuar kjo në pikën 3 të këtij neni. Ndoshur në kushtet e mësipërme, bazuar në ligjin numër 138 të 2015-ës.

Z. A. Llangozi: Referuar këtij fakti që kemi të bëjmë me një vepër penale e kemi parashtruar para jush për arsye se referuar nenit 281 të Kodit të Proçedurës Penale, çdo institucion ose çdo nënpunës publik ka detyrimin ligjor të bëj kallëzim. Unë, ju në përfundim të këtij shqyrtimi ju ftoj që të bëni detyrën tuaj duke bërë kallëzimin përkatës për këtë funksionar që ka mashtruar nëpërmjet ligjit dhe nëpërmjet Kodit të Proçedurës Civile duke paraqitur të dhëna jo të sakta në formularin e dekriminalizimit.

Znj. O. Serani: Vetë qëllimi i ligjit për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen emërohen ose ushtrojnë funksione publike, është të garantojë besimin e publikut në funksionin e organeve të zgjedhura shtetërore, institucioneve të pavarura dhe atyre të krijuara me ligj, të administratës publike nëpërmjet pengimit të zgjedhjes ose emërimit në to apo largimit nga funksionit publik të personave të cilët

*Zbardhi materialin audio
Andoneta GJIKNURI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.13.06.2023*

janë dënuar apo ndaj të cilëve janë marrë masa sigurie ose janë dënuar me vendim jopërfundimtar për kryerjen e krimeve. Sipas këtij ligji dhe objekt i këtij ligji është mbrojtja dhe mirëfunksionimi demokratik të Kuvendit, organeve të qeverisjes vendore, insitucioneve kushtetuese apo të krijuara me ligj, administratës publike, forcave të armatosura, organeve të rendit publik, sigurisë kombëtare dhe çdo institucioni apo entiteti tjetër ekonomik shtetëror nga ndikimi apo pjesëmarrja në politikbërje ndonëse vendimmarrja e personave që janë dënuar apo ndaj të cilëve janë marr masa sigurie ose janë dënuar me vendim jopërfundimtar për kryerjen e krimeve sipas këtij ligji. Duke qënë se zoti Kreshnik Hajdari i cili kandidon edhe në zgjedhjet vendore të datës 14 maj 2023, për kryetar bashkie, si përfaqësues nga Partia Socialiste, ka kandiduar në kundërshtim me ligjin, kemi të bëjmë me një veprim të paligjshëm duke printuar në fletën e votimit dhe emrin e këtij kandidati kur ndërkohë, ky kandidat duhet të ishte çregjistruar dhe fleta e votimit absolutisht e pavlefshme.

Z. A. Llangozi: Nga KQZ-ja ky vendim nuk e di është marr apo jo, është administruar apo jo nga ana juaj, u morr një vendim për administrim por ne nuk e kemi parë kurrë është apo s'është ky vendim, mos e ka marr zoti Shushari dhe atë, këtë nuk e dimë, domethënë zoti Shushari përfaqësues i KZAZ-së Kuçovë, ndoshta i ka ai në shtëpinë e vet. Dhe ajo që është më e çuditshmja është se ky vendim siç na është fshehur ne nga KQZ-ja, i është fshehur dhe institucioneve ligjzbatuese që është Prokuroria e Përgjithshme.

Znj. O. Serani: Pavlefshmëria është për faktin se në fletën e votimit është shënuar kandidati Kreshnik Hajdari, ky person ka patur detyrë të deklaronte urdhërndalimin dhe dënimin e tij referuar nenit 1 të ligjit 131/2015. Vetë fakti se zoti Kreshnik

*Zbardhi materialin audio
Andoneta GJIKNURI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.13.06.2023*

Hajdari ka dhënë përpara KQZ-së deklaratime të pavërteta, e bën këtë formular të paqënë, pasi një akt i pavlefshëm e bën atë akt të mos këtë fuqi juridike. Një tjetër krim që ne e kërkojmë përpara jush është dhe pavlefshmëria e veprimit juridik dhe pikërisht formulari i dekriminalizimit në emër të zotit Kreshnik Hajdari dorëzuar pranë KQZ-së, referuar ligjit 138/2015. Kjo deklaratë është dhënë në kundërshtim me ligjin 138/2015 dhe si e tillë është absolutisht e pavlefshme në kuptim të nenit 92 pika ç, vijues të Kodit Civil, është një deklaratë që ka patur për qëllim të sjellë si pasojë juridike atë pasojë të cilën ka sjellë, veprime juridike të pavlefshme janë në mënyrë të qartë ne nenin numër 2 të Kodit Civil, veprimet juridike të pavlefshme nuk krijojnë asnjë pasojë juridike, të tilla janë ato që bien në kundërshtim me një dispozitë të ligjit dhe që kryen për të mashtruar ligjin, veprime juridike.

Z. A. Llangozi: Kjo e dyta është që Kreshnik Hajdari ka kryer një veprim juridik në kundërshtim të ligjit, e ka patur për detyrë ta deklaronte dhe nuk e ka deklaruar. Do të thotë që ka mashtruar ligjin.

Znj. O. Serani: Veprimi juridik i mësipërm i cili kundërshtohet prej meje është veprim i cili është bërë në kundërshtim me ligjin dhe në shkelje të hapur të Kodit Civil, këtë veprim zoti Kreshnik Hajdari e ka bërë me qëllim dhe me dijeni të plotë pasi në vendimin e dënimit të mësipërm zoti Hajdari ka qënë prezent në momentin e shpalljes së tij, sikurse u parashtrua dhe mësipër gjykata e shqyrtimit në themel të kërkimit dhe kryesisht konstaton pavlefshmërinë absolute të një veprimi juridik, por zgjidh pasojat vetëm brënda kërkimeve. Veprimi juridik.

Z. A. Llangozi: Dhe kjo është një detyrë e lënë nga Kolegji në saj të ankimit tim sepse të ishte për këtë Komision nuk do ishte gjykuar kurrë dhe do kishte përfunduar

*Zbardhi materialin audio
Andoneta GJIKNURI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.13.06.2023*

kushedi te dosjet zoti Shushari, ashtu siç ka përfunduar edhe ai në raftin e kërkesës së bërë nga Koalicioni Bashkë Fitojmë.

Znj. O. Serani: Veprimi juridik që është i pavlefshëm mund të merret parasysh nga gjykata dhe kryesisht pa u kërkuar nga palët e interesuara madje dhe kundër vullnetit të saj dhe kryesisht për të konsideruar një veprim juridik absolutisht të pavlefshëm s'është e nevojshme paraqitja e një kërkesë të posaçme pasi kjo lloj pavlefshmërie konstatohet panvarësisht nga paraqitja në gjykatë e kësaj kërkesë. Pavlefshmëria absolute mund të parashikohet nga çdo palë që ka interes, forma e parashtrimit mund të jetë edhe prapësim, kjo për faktin se vlerësimi juridik absolutisht i pavlefshëm nuk mund të bëhet i vlefshëm me asnjë veprim të mëvonshëm.

Z. A. Llangozi: Pra prapësim është dhe kur ne bëjmë një debat, një debat juridik konstatohet i pavlefshëm madje, madje, në këndvështrimin tim edhe roja i një institucioni mundet një veprim juridik ta konstatojë absolutisht të pavlefshëm. Përshëmbull unë vij përfaqësues i zotit Lefter Maliqi pranë KQZ-së me një prokurë të panënshkruar nga ai, roja më thotë zotëri ti s'je përfaqësues i zotit Lefter Maliqi sepse nuk e ka nënshkruar prokurën zoti Lefter, ky është veprim juridik thotë ai i paligjshëm. Përveç KQZ-së me gjithë këto juristë nuk ka dashur kurrë dhe nuk ka nguruar që ta konstatojë këtë gjë, pra kur e ka mundësinë dhe roja që mos më lejoj të futem në institucion si përfaqësues i klientit tim, imagjino KQZ-ja një institucion që e ka patur detyrë dhe aktualisht dhe ju si kolegji nuk e keni pranuar këtë kërkim me këmbënguljen e zotit Cecfa është thënë që ne nuk mund ta gjykojmë, fatmirësisht që ka asistentë drejtësie dhe gjyqëtar e cila është lënë detyrë për tu gjykuar.

*Zbardhi materialin audio
Andoneta GJIKNURI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.13.06.2023*

Znj. O. Serani: Së dyti zoti Kreshnik Hajdari gjatë fushatës ka vepruar në shkelje të hapur me ligjin dhe me Kodin Zgjedhor dhe pikërisht në kundërshtim me nenin 91 të këtij Kodi, i cili përcakton në mënyrë të qartë ndalimin e përdorimit të burimeve publike në mbështetje të subjekteve zgjedhore me përjashtim të rasteve të specifikuara me ligj, nuk mund të përdoren ose të vihen në mbështetje të kandidatëve.

Z. A. Llangozi: Mund të bëjmë një debat te pjesa, që ta mbyllim pjesën e veprimit juridik të, mos na mërzhitet relatori, në rregull. Në lidhje me veprimet juridike përveç atë që roja mundet të konstatojë pavlefshmërinë e veprimit juridik, veprime të tjera juridike të paraqitura përpara jush është dhe kërkesa përshembull, kërkesa për përjashtim që unë ju bëra ju, ju e rrëzuar atë, ky është një veprim juridik të cilin ne e kemi paraqitur para jush, u shqyrtua, u rrëzua. Veprim tjetër juridik është ankimi që ne kemi paraqitur para jush, që ju jeni duke e sgjykuar këtë gjë, dhe në përfundim do shpreheni dhe në shumicat e kërkesave të tjera që ju ca i keni rrëzuar dhe ca i keni pranuar. Përshembull kërkesa ime që kam thirrur në cilësinë e dëshmitarit zotin Salillari, është rrëzuar si veprim juridik, ju e keni konstatuar të paligjshëm, e keni rrëzuar, është e drejta juaj dhe ne kemi të drejtë të ankohemi në institucione të tjera dhe siç e theksova është dhe prokura e zotit Lefter Maliqi, ju më keni legjitimuar mua dhe kolegen time, pra janë një sërë veprimesh juridike të cilat janë shqyrtuar në këtë proces, janë shqyrtuar edhe në Kolegj, me këtë arsyetim dhe Kolegji e ka lënë këtë si detyrë. Kalojmë të faza tjetër që zoti Hajdari ka vijuar fushatën në kundërshtim me Kodin Zgjedhor, të cilin ne do ta parashtrojmë më poshtë, i kemi paraqitur provat për zotin Hajdari në çdo moment referuar rrjetit të tij Facebook, ka publikuar foto nga fushata me administratën e tij në orar pune dhe i kemi përcaktuar dhe oraret përkatëse në disa prej pamjeve, të tjerat janë të shkruara në prove.

*Zbardhi materialin audio
Andoneta GJIKNURI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.13.06.2023*

Znj. O. Serani: Në lidhje me nenin 91 të Kodit Zgjedhor i cili përcakton në mënyrë të qartë se ndalimi i përdorimit të burimeve publike në mbështetje të subjekteve zgjedhore, me përjashtim të rasteve të parashikuara me ligj, nuk mund të përdoren ose të vihen në mbështetje të kandidatëve të partive politike, ose të koalicioneve në zgjedhje, burimet e organeve apo enteve publike në nivel qendror ose vendor, apo çdo enti tjetër ku shteti zotëron kapital, kuota se zoteron emëron shumicën e organeve mbikqyrës ose organit administrues të entit, panvarësisht nga burimi i kapitalit ose pronësia. Në kuptim të këtij neni burim quhen asetë të luajshme ose të paluajshme të parashikuar në nenin 142 të Kodit Civil, si dhe çdo burim njerëzor të çdo institucioni, me përdorim i burim njerëzor kuptohet përdorim i detyruar në fushatë zgjedhore i administratës së institucionit brenda orarit të punës për qëllime zgjedhore, si dhe përdorimi i detyruar dhe i organizuar brenda orarit mësimor i nxënësve të sistemit shkollor parauniversitar në fushatën zgjedhore.

Z. A. Llangozi: Rëndom kemi parë vendime të KQZ-së, të gjobiten persona që janë në administratë, të merren masa, nuk është ky qëllimi i ligjvënësit, qëllimi i ligjvënësit është që të garantohet një garë e barabartë me kandidatin tjetër. Pra potenciali që merr fonde nga buxheti i shtetit të mos përdoren për qëllime fushate, nuk është qëllimi u gjobit apo s'u gjobit, s'i intereson as ligjit as shtetit dhe asnjëri, ajo është qëllimi që këto persona të ndëshkohen nga ligji me gjobë 50 mijë lekë aq sa e ka lënë, me qëllim që të mos kryhen veprime në kundërshtim me Kodin Zgjedhor për të favorizuar njërin apo kandidatin tjetër. Për këtë arsye mendojmë që edhe ligjvënësi ka patur këtë synim, nuk ka patur synim që të ndëshkohet me një gjobë 50 mijë lekshë, se s'ngeli shteti për 50 mijë lekshin e atyre.

*Zbardhi materialin audio
Andoneta GJIKNURI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.13.06.2023*

Av. O. Serani: Në foton që ne kemi paraqitur në USB kur kemi paraqitur një grup videosh dhe fotosh. Në një prej tyre kemi paraqitur në datën 12.05.2023 ora 13:00 është provuar se zoti Kreshnik Hajdari ka postuar në profilin e tij në facebook në orar zyrtarë domethënë ora 13:00 në Kuçovë, një lokacion në Kuçovë dhe me shënimin një super takim me banorët e Lumasit ku mbështetja për Partinë Socialiste dhe Kreshnik Hajdarin është me e madhe se asnjëherë më parë. Punën që kemi bërë deri më tani janë provë që nuk ka nevojë për shumë llafe e të tjerë që vazhdon postimi i tij që...


Av. A. Llangozi: Vetëm përpara thotë....

Av. O.Serani: Në këtë video është e gjithë administrata e bashkisë, OSHI-së, ASHK, punonjës të transportit madje këta persona janë detyruar të marrin pjesë edhe persona të SHRSF-së Ilirian Guard e të tjerë.

Av. A. Llangozi: Vinte ministri atë ditë edhe përderisa derisa vinte ministry edhe vetë policia dhe ato institucione që mbështesin policinë ose të krijuara nga Policia e Shtetit siç është Ilirian Guard do të ishin aty prezent. Pra e gjithë administrata në mbështetje të këtij kandidati.

Av. O.Serani: Po ashtu është e provuar se zoti Kreshnik Hajdari ka postuar po ashtu në profilin e tij në Tapi të madhe ku në rrugën e re hyrëse do të vijohet të shkohet më shpejt dhe ku ka marrë vendimin për drejtimin që duhet të ecim. Në këtë postim zoti Hajdari ka postuar foton në orën 14 e 33 minuta po në këtë video është e gjithë administrata e bashkisë, punonjës dhe drejtues të ASHK-së. Postimin tjetër po prapë në datën 07.05.2023 ora 11 e 45 në Vodës në datën 04.05.2023, në datën 01.05.2023

*Zbardhi materialin audio
Ardita ÇAMI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.13.06.2023*

edhe një sërë videosh edhe fotosh të cilat ne i kemi depozituar në cilësinë e fotos dhe që tregojnë që administrata dhe zoti Hajdari gjatë orarit të punës kanë kryer veprimtari në lidhje me fushatën e tij elektorale.

Z. L. Maliqi, kandidat i BF-së: Të gjitha këto zona janë të majta ku kam fituar unë, po në kuti pavarësisht se çfarë thotë zotëria në kuti ka më shumë vota se çfarë janë gjetur.

Av. O.Serani: Të tilla veprime duke përdorur administratën ka pa fund dhe duhet të konstatohet veprimtari e pa ligjshme e zotit Hajdari në kundërshtim me nenin 91 të Kodit Zgjedhor, në të cilin përcaktohet në mënyrë të qartë se ndalimi i përdorimit të burimeve publike në mbështetje të subjekteve zgjedhore me përjashtim të rastit të parashikuara me ligj nuk mund të përdoren ose të vihen në mbështetje të kandidatëve ashtu sikurse janë bërë në rastin konkret. Në Bashkinë Kuçovë në datën 04.04.2023 nga kompania Salillari me përfaqësues ligjor zotin Pëllumb Salillarin Sh.p.k është shtruar rreth 2km sipërfaqe rrugë me asfalt në fshatin Tapi të Bashkisë Kuçovë. Ky ndërtim nuk ka lejë nga ana e Bashkisë Kuçovë dhe si rrjedhojë është ndërtim pa leje. Dhe për këtë fakt nga kompania Salillari me përfaqësues ligjor zotin Salillari ka konsumuar plotësisht elementët e veprës penale të parashikuara nga neni 199 franksion a paragrafi 3 i Kodit Penal që ka të bëjë me ndërtimin e paligjshëm.

Av. A. Llangozi: Përveç kësaj edhe në kodin zgjedhor është e përcaktuar qartë që një kandidat nuk duhet të marrë përfitime nga persona të cilët ai ka marrëdhënie kontraktore, me zotin Salillari, Kreshnik Hajdari ka me 10-tra kontrata të cilat i ka funksionale. Ky subjekt tregtar fjetë gjithë kohës ka ndikuar në mënyrë të drejtëpërdrejtë në çdo zonë duke çuar material të shtrimit të rrugëve në këmbim të

*Zbardhi materialin audio
Ardita ÇAMI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.13.06.2023*

ndihmës që po i jepte këtij kandidati me qëllim mbrotjen e të gjithë veprimtarisë kriminale të tij të mëparshme ose kontratave të cilat i ka përfutuar në mënyrë të paligjshme. Ne kjo na çon të dyshojmë sepse veprimi i kryer nga ky subjekt tregtar në ndihmën që ai i ka dhënë këtij kandidati për Kryetar Bashkie vjen ndesh si me Kodin Zgjedhor por edhe me ligjin për konfliktin e interesave që ka të bëjë me kryetarin e bashkisë i cili përfiton të mira materiale të cilat duhet edhe të ishin deklaruar edhe përpara jush, gjithësesi nuk janë deklaruar këto janë të tjera probleme. Por përfiton të mira materiale nga ai person që ka lidhur kontratë më parë.

Av. O.Serani: Një kohësisht ka dyshime të bazuara në prova se zoti Kreshnik Hajdari dhe zoti Pëllumb Salillari kanë konsumuar element të vepres penale të korrupsionit. Salillari ka ndërtuar pa leje dhe lejohej të ndërtoj nga zoti Kreshnik Hajdari me qëllim përfitimin e paligjshëm nga ana e Hajdarit. Zoti Kreshnik Hajdari dhe zoti Pëllumb Salillari janë nënshkrues të disa kontratave me njëri tjetrin në kuadër të disa tenderave të cilët janë kallzuar si korruptiv në dukje janë konflikt interesi për këtë arsye duhet të hetohen në këtë aferë korruptive si dhe përfitimet që janë marrë nga Salillari por njëkohësisht duhet të hetohen edhe ato tendera që janë në proces. Pasi dyshimi do të favorizonte nga përfituesi i favoreve të paligjshëm zoti Hajdari. Bazuar në nenin 23 të ligjit nr.9367 datë 07.04.2005 është i përcaktuar qartë ndalimi i marrjes së dhuratave, favoreve, premtimeve ose trajtimeve preferenciale dhe në pikën 1 të këtij neni përcaktohet qartë se është e ndaluar që një zyrtar të kërkojë ose të marrë në mënyrë të drejtëpërdrejtë ose të tërthortë dhurata, favore, premtime ose trajtime preferenciale të cilat jepen për shkak të pozicionit të tij nga një individ person fizik ose person juridik. Përfitimet dhe shërbimet e marra nga zoti Hajdari janë përfitime të ndaluara për këtë arsye referuar nenit 23 te ligjit 9367 datë 07.04.2005 këto veprime janë kryer me qëllime përfitimi dhe me qëllim favorizimin

*Zbardhi materialin audio
Ardita ÇAMI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.13.06.2023*

e një subjekti që në rastin aktual është ofruesi i shërbimit që është zoti Salillari. Duke analizuar faktin e mësipërm dhe legjislacionin rezulton se zoti Kreshnik Hajdari ka konsumuar plotësisht elementët e veprës penale të parashikuara nga neni 260 i Kodit Penal. Zoti Pellumb Salillari i cili i ka dhënë përfitime Kryetarit të Bashkisë Kuçovë është i përfshirë në këtë vepër penale. Bazuar në nenin 245 të Kodit Penal është e përcaktuar qartë se premtimi propozimi dhënia drejtëpërdrejtë ose tërthorazi i çfarë do lloj përfitimi të pa rregullt funksionarëve të lartë shtetëror ose të zgjedhurëve vendorë për vetë ose për persona të tjerë për të kryer ose për të mos kryer një veprim që lidhen me detyrën apo funksionin e tij dënohet me burgim nga një deri në 5 vjet. Të tilla veprime korruptive...

Av. A. Llangozi: Pra, jo pa qëllim iua parashtruam edhe ju përderisa ne i kemi sjellë në cilësinë e provës të gjithë ato material është detyrë në rastin konkretë ju si trup gjykues ti shqyrtoni këto materiale dhe ti drejtoheni me kallëzim penal sepse vetëm në këtë formë bëhet Shqipëria, kur ndëshkohet një shkelës ligji. Në rastin konkret jo vetëm se është shkelur ligji po është favorizuar në disa drejtime dhe mendojë se është detyrë e juaja. Ne e kemi bërë detyrën tonë se kemi frikë për mos kallëzim krimi, i kemi bërë kallëzimet përkatëse aktualisht ka edhe hetime.

Av. A. Llangozi: Në lidhje me procedurën e votimit. Një fakt që është i provuar se kemi të bëjmë me shkelje të procedurave ligjore dhe manipulim të votave është edhe fakti se në QV 3516 Vodës Shkolla 9 vjeçare njësia Lumas në kutinë e votimit ka pasur kundërshtime nga anëtarët e GNV-ve nr. 3 zoti Xhafer Haxhillari dhe Qazime Dardha me shënimin se nuk u gjetën fletët e mbylljes së kutisë as në kutinë e votimit dhe as në kutinë e materialeve të cilat nuk i kishte të saktësuara saktë procedurat. Kutisë së materialeve nuk i përputheshin vulat, vulat ishin të shënuara ndryshe në

*Zbardhi materialin audio
Ardita ÇAMI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.13.06.2023*

procesverbalin e gjetur procesverbalit të gjetur nuk i përputheshin të dhënat, të dhënat nuk ishin shënuar me fjali procesverbali nuk mbante as datën dhe as orën e mbylljes, as numrin e qëndrës, as procesverbalin e mbylljes.

Av. A. Llangozi: Për më tepër nuk dimë se cili nga procesverbalët origjinal ishte në kuti, mund të kishte qenë ndonjë procesverbal që na ka sjellë zoti Shushari këtu. Pra në lidhje me këtë fakt ne nuk kemi hetuar fare domethënë, këtë e ngritur si problematikë, hetimi që ne i kemi bërë këtu nuk është kundërdrejtuar në këtë pavarësisht se ka pasur kontestime. Është mbyllur hetimi gjyqësor sepse më e rëndësishme është marrja e një vendimi në favor të një kandidati se sa dhënia e një drejtësie. Pra, në lidhje me këtë fakt, nuk është hetuar fare.

Av. O.Serani: Një tjetër fakt që është i provuar se kemi të bëjmë me manipulim të votave, është edhe fakti se në QV 3417 Krekës Shkolla Fillore njësia Lumas ka pasur probleme me pajisjen PEI. Është votuar manualisht për 50 qytetar, 45 prej të cilëve nuk figurojnë në sistemin TIMS brenda territorit të Republikës së Shqipërisë në ditën e votimit. Nga informacionet që ne kemi marrë në rrugë operative njëri prej këtyre është shtetasi Lavdërim Qemal Tomorri ka edhe gjeneralitet në kërkesën që ne kemi paraqitur po ashtu edhe në konkluzione. Ky fakt është një indicie për të hetuar çdo kuti kur nuk ka punuar sistemi i kamerave dhe pajisja PEI. Përpos shkeljes administrative e cila është në kundërshtim me Kodin Zgjedhor ku në nenin 105 janë të parashikuara rregullat për paraqitjen e zgjedhësve në QV.

Av. A. Llangozi: Për këtë kërkim që ne kemi bërë kemi marrë vendim jo përfundimtar, që na është rrëzuar dhe nuk është se presim ndonjë gjë kushedi ato vendime të cilat ne i kemi kundërshtuar dhe faktin që këtu kemi të bëjmë me

*Zbardhi materialin audio
Ardita ÇAMI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.13.06.2023*

parregullsi nuk duhet të merren parasysh. Sepse është detyra e kandidatit që të vëj pamjet filmike, dhe janë me miliona euro që shpenzohen për këto pamje filmike që duhet të garantojnë një process të rregullt, është detyra e kandidatit që duhet ti monitorojë të vëjë kamera dhe nuk është e KQZ-së, me ato specialistë që marrin lekët. Por ajo që ne na lind më shumë dyshimi është fakti se kjo pajisje nuk ka funksionuar sepse është dëmtuar dhe ka rezulucion shumë të ulët ose nuk ka fare mund të jetë bërë me ndonjë sprajt të ndryshëm. Pra, aty nuk kuptohet fare se çfarë është bërë dhe nuk mundet që ne aktualisht ti besojmë atyre njerëzve se çfarë është votuar. Ne kërkuam hapjen e kësaj kutie, për rinumërim dhe verifikimin e gjithë dokumentacionit por njëkohësisht edhe për rinumërimin e saj, është rrëzuar kjo kërkesë mendojmë që në kolegji ditën e nesërme të marrim përgjigje se nga ju e kam marrë.

Z. L. Maliqi, kandidat i BF-së: Kjo është njësia administrative Lumas me rreth 9 QV. Ku në 8 QV unë jam fitues, tek kjo qëndër është përqindja më e madhe e votuesve ndërkohë që janë dy fshatrat më të vegjël njëri pas tjetrit. Pra 120 votues mund të ishin sipas të dhënave dhe nuk del aty me figurë se janë fshirë dhe aty raportohet rreth 180, 190 votues. Prandaj ne morën indicien e parë çështje kjo pjesëmarrje e madhe kjo përqindje. Ndërkohë që ishte 30-40% në shkallë bashkie dhe këtu ishte rreth 50%.

Av. O.Serani: Gjatë dorëzimit të kutive janë konstatuar parregullsi dhe janë dorëzuar dorazi vulat nga komisionerët dorëzues të disa qëndrave, prej të cilave njëra është fshëhur në kartonin e vulave të sigurisë e provuar kjo me fotografinë përkatëse. Në Kodin Zgjedhor, dhe pikërisht në nënin 113 , pika 5 të tij është parashikuar qartësisht se : Në perfundim të veprimeve të parashikuara në pikat 1 deri në 4 të këtij neni

*Zbardhi materialin audio
Ardita ÇAMI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.13.06.2023*

mbyllet në kutitë e materialeve zgjedhore, ndër të tjera vula e KQV-së, vula e Kryetarit të KQV-së, vulat me Kodet e Sigurisë të papërdorura dhe vulat në kodet e sigurise të dëmtuara. Fakt ky i cili nyk është hetuar nga ana e KAS-it. Gjatë procesit të numërimit sipas protokollit të përmbledhjes së KZAZ-së, është mbajtur shënim gjatë procesit zgjedhor se : në Qëndrën e Votimit 3424/01, njoftoi KZAZ, kanë dëmtuar vulat pasi kanë vulosur gabimisht kapakët e materialeve zgjedhor në kutitë e votimit për kryetarin e bashkisë. Duke qënë se ky kapak nuk ka carje për lejimin e votimit, janë dëmtuar vulat, dhe është vendosur sërish kapaku i kutisë së votimit për kryetar bashkie. Qendra vendore kërkon dy vula të tjera shtesë për vulosjen e kutisë. KZAZ, vendosi të pajisë këtë Qëndër Votimi me dy vula shtesë më Kode dhe janë kodet përkatëse për të dyja këto. Këto rrethana provojnë se kemi të bëjmë me hapje te vulave dhe mosvulosje të kutive të materialeve zgjedhore. C'ka tregon mundësi aksesimi për ndikim në vota dhe rrjedhimisht rezultatet zgjedhore , fakt ky i paevituar nga ana e KAS-i. E njëjta dhe me një qëndër tjetër ku në pajisjen me vulën zero, është numri i vulës, shënimi gjendet në librin e protokollit. Anëtarët e grupit te numërimit, pasi numëruan kutitë me numër qëndre 3416, kanë mbyllur në kuti zarfin pa bërë raportimet për numrin e votuesve gratë dhe burra. Për këtë arsye vendoset rihapja e kutisë. Ripahet dhe vendoset keto Kode. Qendra numër 3415, kanë mbyllur kutitë pa plotësuar të gjitha zërat e kërkuara tek tabela e rezultateve Kutia ripahet dhe vendosen këto kode. Në QV 3501 rihapet kutia e materialeve për mos përputhje votash. Jepen vula sigurie...

Av. A. Llangozi: Pra, zoti Çefa meqë e ngriti si problem dje që a keni prova?! Një ndër provat është, dhe është në librin e protokollit, që kemi mos përputhje votash.

*Zbardhi materialin audio
Ardita ÇAMI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.13.06.2023*

Av. O.Serani: Grupi i numërimit nr.3 që po numëronte këtë qëndër, QV 3513 ka konstatuar se vulat e mbylljes nuk përputheshin dhe njoftoi KZAZ-në. KZAZ për këtë fakt se me vulat e kutisë të këshillit B ishte mbyllur kutia për kryetarin B, KZAZ vendos të rihap kutitë e materialeve fakt ky i pa hetuar nga ana e KAS. Kutisë së numrimit nr.3516 i mungon procesverbali i mbylljes, KZAZ vendos të hap kutinë e materialeve për QV 3518, 3519, 3519/1, në QV 3523 u konstatuan 2 vota të cilat u kundërshtuan nga anëtarja e “Bashkë Fitojmë”. U mblodh KZAZ dhe vendosi ti quaj të pavlefshme, votuan pro 6 anëtarë dhe 1 ka kundërshtuar, fakt që tregon se kemi të bëjmë me një manipulim të votuesve dhe se duhet të hetohen komisionerët e QV 3518, 3519, 3519/1. Me këtë veprim duke i nxjerrë dy fletë votimi të pavlefshme ndërkohë që nuk janë të tilla.

Av. A. Llangozi: Pra, procesverbali i mbylljes nuk është gjetur asgjë kundi, ndoshta e ka Shushari sdihet ku është. Nuk është gjëndur në kuti dhe është në procesverbal kjo gjë.

Av. O.Serani: E njëjta gjë është konstatuar edhe në QV 3525/03 ku në kutinë e kryetarit të bashkisë nuk është gjëndur procesverbali i mbylljes së votimit. Për këtë arsye do të hapet kutia e materialeve zgjedhore. Në QV 3516 për shkak se nuk është gjëndur procesverbali i mbylljes KZAZ vendosi të pajisë GNV-në me katër vula shtesë e njëjta gjë edhe për QV 3519/1 dhe për QV 3528/01 në kutinë e votimit për këshillin bashkiak procesverbali i mbylljes është gjetur pa vulën e QV . GNV njoftoi KZAZ-në, e cila vendos rihapjen e kutisë së kryetarit fakt ky i pa hetuar nga ana e KAS. E njëjta skenar mbulimi të mos rakordimit me numër votash fizike në kuti me

*Zbardhi materialin audio
Ardita ÇAMI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.13.06.2023*

atë të shënuar në procesverbale ka ndodhur në QV 3525/00, 3526 etj, etj. Gjatë numërimit janë rakorduar shifrat më të pavlefshme


Av. A. Llangozi: Janë ato kuti që kanë bërë edhe diferencën më pas. Nga 325 deri në 335 janë ato kuti që ndodheshin tek ajo dera atje dhe janë edhe kuti që bën edhe diferencën e votave me zotin Lefter Maliqi.

Av. O.Serani: Gjatë numërimit janë rakorduar shifrat me të pavlefshmet që në fakt nuk ndodheshin fizikisht aty. Nëse hapet sistemi i kamerave do daloheshin kundërshtitë e komisionit të numërimit lidhur me këtë fakt, i cili nuk është shënuar në librin e protokollit. Emrat e komisionerëve që kanë dijeni për këtë janë Alma Cela, Kreshnik Liçi, Edmond etj theksojmë se ka pasur shumë mos rakordime në numër votash për çdo tavolinë. Kjo për faktin e prishjes dhe fallsifikimit të materialit zgjedhor. Votat në disa kuti, në kutinë e kandidatit për kryetar bashkie ishin të njolloosura me bojë vule. Në disa raste nuk dallohej dot prej bojës as shenja e votimit. U mor vendim nga KZAZ që gjithësesi të kalonin si të flefshme pasi ka pasur probleme me bojën e vulave.

Av. A. Llangozi: Këtë fakt e pohoj edhe vetë kryetari i KZAZ-së domethënë që ka pasur problematika me bojën e vulvae. Kështu që ne nuk është se kemi gënjyer në këtë fakt por është pranuar edhe nga vetë personi. Kështu që është një provë, marrja e dëshmisë së zotit Shushari është një provë më vetë referuar edhe faktit që ne kemi paraqitur.

Av. O.Serani: Përpara fillimit të numërimit është konstatuar nga KZAZ mos funksionimi i mirë i kamerës së sigurisë e cila nuk mbulonte dot as tavolinën numër

*Zbardhi materialin audio
Ardita ÇAMI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.13.06.2023*

5 të numërimit dhe aspak ambjentin shtesë ku vendoseshin materialet dhe pajisjet PEI tek e cila pas një dollapi në këtë ambjent shtesë ka pasur një derë të mirëfilltë kalimi lidhëse me ambjentet e pa ndriçuara të shkollës së mesme ngjitur pasi qëndra ishte e pajisur vetëm me një kamer sigurie katër dimensionale e jo si herët e tjera me një kamera për tavolinë dhe as dhoma shtesë e materialeve nuk kishte kamera sigurie. Ndërkohë që sipas Kodit Zgjedhor dhe pikërisht në nenin 94 pika 5 e tij ndër të tjera është e përcaktuar qartë se KQZ vendos përdorimin e kamerave rregjistruese dhe të monitorëve për shfaqjen e fletëve të votimi përpara vlerësimit të tyre. Kamera me rezolucion të lartë instalohen mbi tavolinën e numërimit në mënyrë të tillë që të bëjë të mundur rregjistrimin e vlerësimit të çdo flete votimi.

Av. A. Llangozi: Pra, pamjet filmike ka vetëm një kamera, që ka vetëm një tavolinë edhe katër tavolina të tjera nuk e konstatuan me dije nuk duket gjë se çfarë mund të bëjnë komisionerët e numërimit.

Av. O.Serani: Në kutinë 3517 /01 mungon procesverbali origjinal i mbylljes. Në kutinë 3523/01 mungon procesverbali origjinal i mbylljes. Në kutinë 3525 mungon proseverbali origjinal i mbylljes, në kutinë 3525/03 mungon procesverbali origjinal i mbylljes.

Av. A. Llangozi: Pra, këto janë konstatime që janë bërë dhe nuk janë hetuar sepse ndoshta nuk do zbardhet kurrë por mbase prokuroira do t'i hapi këto.

Av. O.Serani: Në lidhje me votimin shkeljet në QV 3414 në këtë qëndër ka pasur shkelje nga vendi i pozicionuar i kameras për mbikqyrjen e situatës së votimit dhe dhomës së votimit. Është vendosur në mënyrë jo shumë korrekte pasi siç shihet edhe

*Zbardhi materialin audio
Ardita ÇAMI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.13.06.2023*

nga filmimet mënyra e vendosur nuk jep një transparencë të korrektësisë së votuesve dhe neglizhencës së stafit të komisionerëve dhe vëzhguesve. Në QV 3414 kemi votime në grup në videon e parë e kemi shënuar me

Av. A. Llangozi: Kemi sjellë komplet materialin me sekuenca janë 500 video, të cilat kanë me sekuenca nga 1 minutë deri në 2 minuta ku kemi votime në grup. Nga ajo që ne kemi numëruar janë rreth 1250 vota të pa vlefshme sepse kanë votuar në grup personat.

Av. O.Serani: Votimi në grup bie ndesh me nenin 108 të Kodit Zgjedhor...

*Z. L. Maliqi, kandidati i BF-së:*Këto janë përcaktuar tek 40 e më shumë kuti, ndërkohë që mbi 8-9 kuti janë që nuk duket fare se çfarë është bërë, i ka bërë me sprajt kamerat.

Av. A. Llangozi: Ka shumë QV të cilat janë bërë me sprajt dhe nuk duket fare se çfarë veprimesh kryhen aty, sidomos ... Sepse kjo është e dyshimtë se në të gjitha kutitë që ne kemi paraqitur ankesë bëhet fjalë për 17 kutitë e fundit, ku është bërë edhe diferenca e votave kamerat në asnjë rast nuk kanë funksionuar.

*Zbardhi materialin audio
Ardita ÇAMI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.13.06.2023*

Z. A. Llangozi, avokat: Kamerat e tjera kanë qenë... njëra ka qenë e pozicionuar keq, njëra ka funksionuar 2 orë e 60 minuta. Ndërkohë kamera tjetër...kamerat në përgjithësi asnjëra nuk ka kapur asnjë lloj fakti dhe për çudi që shumica e qendrave të votimit kanë dalë me një diferencë të njëjërë, numri 109 me...

Znj. O. Serani, avokate: Në qendrën e votimit 3414 kemi kemi votim në grupin e parë të videove në minutin e 9, veprim ky që bie ndesh me nenin 108 të kodit zgjedhor. Po lexoj vetëm videot në të cilat pasqyrohet votimi në grup, Në qendrën 3414 votim në grup në minutin 22, në minutin 46 personi pasi voton për personin tjetër shkon të votojë përsëri, veprim ky që ie ndesh me nenin 108 të Kodit Zjedhor. Në videon me numër 1137 konstatohen votime në grup në minutin e 21 dhe në minutin e 27, veprim ky që bie ndesh me nenin 108 të Kodit Zgjedhor. Në videon me nr. 1123 konstatohet votim në grup në minutën e 43, veprim ky që bie ndesh me nenin 108 të Kodit Zjedhor. Në videon me nr. 1124 konstatohet votim me më shumë se 3 persona, veprim ky që bie ndesh me nenin 108 të Kodit Zjedhor. Në videon 1124 konstatohet votim në grup në minutën e 29, veprim që bie ndesh me nenin 108 të Kodit Zjedhor, Po ashtu në videon 1127 konstatohen votime në grup, kthehet dikush nga jashtë dhe shkon të votojë për personin tjetër, kjo në minutën e 10 dhe të 17, veprime që bien ndesh me nenin 108 të Kodit Zjedhor. Në qendrën e votimit nr. 3494, nuk ka patur shkelje nga vendi i pozicionuar i kamerës për mbikqyrjen e situatës së votimit...

Z. A. Llangozi, avokat: Kamera këtu ka qenë e funksionuar shumë pak dhe aty është bërë batërdia pastaj. Kemi 300 vota që janë të pavlefshme sepse këtu nuk kemi një votim që të jenë 2 veta, por këtu janë të gjitha votimet grup nga 3 veta.

*Zbardhi materialin audio
Arlinda BAHOLLARI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.13.06.2023*

Znj. O. Serani, avokate: Në këtë qendër votimi, në 10 video që ne kemi paraqitur provohet se votohet mbi 3 persona në 1 IEPV dhe kontrollojnë votë e njëri – tjetrit. Në tërësi të kësaj qendrë kemi të bëjmë me një implikim prej 300 personash që kjontrollojnë njëri – tjetrin në votime. Pa vetëm në këtë qendër kemi të bëjmë me një numër prej 300 votash të pavlefshme. Në qendrën 3494 situata për të votuar kthehet në situatë komike, ku në të cilën ç’do votues votonte në grup duke i kontrolluar votën njëri– tjetrit dhe asnjë nuk votonte në privatësi. Grupi i vëzhguesve dhe komisionerët nuk patën ndërmarrë asnjë lloj mase për ndalimin e kësaj situatë. Paraprakisht në këtë dokument të paraqitur ç’do votim është bërë në grup nga votuesit siç shihet edhe nga pamjet filmike. Provohet nga pamjet filmike, të cilat pasqyrojnë realitetin se çfarë ka ndodhur në të vërtetë. Në videon me nr. 10, QV 01 minuta 11:32 ku dy prej votuesve shkojnë të votojnë së bashku me një votues, pa u shqetësuar aspak për kodin e etikës së votimit. Në minutin 18:30 komisionerja shkon për të votuar në dhomën e votimit dhe pikërisht në atë moment komplet vëzhguesit dhe një pjesë e komisionerëve mblidhen rreth e qark se për cilin kandidat komisionerja do të votonte, veprim ky që bie ndesh me nenin 108 të Kodit Zjedhor. Gjithashtu ka patur votim në grup në tërësi. Vëzhguesi voton për votuesin e moshuar dhe në pamje filmike është ai që mbyll fletën e votimit pasi ka përfunduar dhe jo votuesi. Në videon me nr, 4 votimi në grup pa u shqetësuar, asnjë nga komisionerët apo vëzhguesit, veprime këto që bien ndesh me nenin 108 të Kodit Zjedhor. Po ashtu në video me nr. 5 votime në grup nga çdo votues që paraqitet. Ne videon me nr. 6...

Z. A. Llangozi, avokat: Pra, këtu ju i keni materialet që ta shkurtojmë këtë pjesë. Bëhet fjalë për 300 vota të cilat ne i kërkojmë të pavlefshme sepse nuk është respektuar ligji. Pra nëse ne i referohemi hierarkisë ligjore, Konventa Europiane e të

*Zbardhi materialin audio
Arlinda BAHOLLARI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.13.06.2023*

Drejtave të Njeriut që në viti 1952 në nenin 3 të saj ka përcaktuar qartë që vota duhet të jetë e fshehte. Ndërkohë ne këtu jemi 100 vjet më pas dhe vazhdohet akoma të votohet në grup. Kjo është e çuditshme, e kundërligjshme, por referuar edhe Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë por edhe Kodit Zgjedhor...Në i referohemi Kodit Zgjedhor, i cili i përcakton qartë rastet dhe mënyrën se si votohet në grup. Pra ne kemi marrë dhe gjithë procesverbalet përkatëse nga KQZ-ja dhe nuk janë deklaruar në këto votme që këto persona mund të kenë pasur probleme shëndetësore. Më e çuditshmja është se shumica e personave që votojnë në grup janë të rrinj dhe jo moshë e tretë.

Znj. O. Serani, avokate: Ajo që është më e çuditshmja, unë e citova dhe në fillim të kësaj seance që ne kemi paraqitur një video ku një person merr fletën e votimit dhe nuk e hedh fare në kuti dhe korensponon mumri i fletëve të votimit me numrin e prsonave që kanë shkuar për të votuar, ndërkohë që duket mjaft qartë që ajo fletë nuk futet në kuti. Kemi një video tjetër ku një person po ashtu...jo korensponon sipas...

Z. A. Llangozi, avokat: Po jap një shembull shumë të thjeshtë. Nëse i referohemi pamjeve të QV-së 3494. Kryetarja e Komisionit gris fletën e votimit dhe sipas KQZ-së janë fletë votimi të rregullta. E gris, duket në pamje filmike. Se si kanë dalë në rregull këto e di vetëm KQZ-ja.

Z. I. Rusmali: Pa mikrofon, nuk dëgjohet.

Z. A. Llangozi, avokat: 3494, jo verifikuam tjetër, ky është tjetër rast. Por përderisa KQZ-ja i ka në rregull tabelat...e ka grisur e ka hedhur, është jashtë, duket qartë.

*Zbardhi materialin audio
Arlinda BAHOLLARI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.13.06.2023*

Z. I. Rusmali: Dakord!

Z. A. Llangozi, avokat: E ka grisur dhe duket kur e hedh. Nuk është e grisur rastësisht, atë e ka grisur vetë komisionerja dhe e ka hedhur në kosh. Duket në video, nuk është se ne... Këto janë, i kemi me tabelat përkatëse. Bëhet fjalë për 1250 vota të cilat janë votuar në grup. Të gjitha këto vota janë të pavlefshme dhe si përfundim pretendimet e kandidatit dhe pretendimet tona janë që ne të kërkojmë edhe rinumërim të të gjithë kutivë përderisa kemi parregullsi të panumërta, përderisa procesverbalet origjinal dhe jo origjinal janë në dorën e zotit Shushari që kanë ardhur 1 muaj me vonesë këtu. Nuk dimë se çfarë ka ndodhur me ato kuti. Është në të mirën e të gjithëve që të bëhet transparencë. Për këtë arsye ne kërkojmë hapjen dhe rinumërimin. Le të presë zoti Hajdari edhe një ditë edhe të bëhet dhe kandidatit tjetër ti ikë ai mendimi tjetër që mund të ketë negativ.

Z. L. Maliqi, kandidat i BF-së: Si informacion që kam nga anëtarët e KZAZ-së të Bashkë Fitojmë, 17 kutitë e fundit që u bë ndryshimi i rezultatit, 3524/1 – 3531/2 të fundit, shumica janë me bojë të rrëshkitshme siç tha dhe kryetari e me radhë. Në qendrën 3497 që avokati nuk e ka sjellë me filmime të prera, janë 60 rastë të tjera në grup që i ka nxjerrë anëtare e KZAZ-së duke i parë ,por që nuk janë të prera, 3497...

Z. A. Llangozi, avokat: I kemi sjellë dhe ato. Janë të prera, i kemi bërë mbrëmë, kanë punuar 4 veta tërë natën që i kanë prerë të gjitha videot. Po në diskun blu që kemi sjellë.

Z. K. Bele: Po, përfundimisht u shprehët për...

*Zbardhi materialin audio
Arlinda BAHOLLARI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.13.06.2023*

Z. A. Llangozi, avokat: Përpara se ju të jepni vendimin unë mendoj se ka ngelur dhe një veprim tjetër pa u kryer. Që ne të jemi transparent duhet të hapen të gjitha kutitë, të numërohen, të shikohen se çfarë ka. Pretendohet gjithandej, edhe në procesverbale, edhe me kundërshtimet që nuk janë gjetur procesberbalet origjinalë. Ne kërkojmë hapjen e kutive, rinumërimin e tyre dhe më pas do të mbajmë edhe një qendrim përfundimtar jo të zgjeruar por shkurtmisht.

Z. K. Bele: Lidhur me pretendimin tuaj për hapjen e kutive u shprehëm në seancën paraardhëse, këtu jemi te konkluzionet përfundimtare. Kërkimi jua përfundimtar është? Nga ajo që keni këtu me shkrim është pavlefshmëria, na keni paraqitur 5 pika...

Z. A. Llangozi, avokat: Ju e pranoni dhe vet që keni marrë vendim përfundimtar apo jo? Përderisa na e keni rrëzuar, na e keni rrëzuar dje...

Z. K. Bele: Disa konkluzione duhen me shkrim. T'i administrojmë...

Z. A. Llangozi, avokat: Jo ajo që ju thatë është se e keni marrë dje vendimin apo jo?

Z. I. Rusmali: Për marrjen e provës.

Z. A. Llangozi, avokat: Nuk dua marrje provash, kërkoj rinumërim.

Z. K. Bele: Avokat atëherë, administrojmë konkluzionet tuaja përfundimtare. Janë të firmosura. Faqe ju thatë 19. Po i administrojmë pjesë të procesit. Faleminderi!

*Zbardhi materialin audio
Arlinda BAHOLLARI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.13.06.2023*

Z. M. Legisi, përfaqësues i PS-së: Faleminderit i nderuar. Prapësimet i keni në faqe më shkrim në mënyrë të përmbledhur, duke i marrë një nga një për sa... Jo ne e kishim lënë për këtë seancë konkluzionet përfundimtare dhe datën po t'a shikoni e kam vënë me stirolaps jo me... I keni me shkrim i nderuar. Për sa i përket të gjitha pretendimeve që lidhem me pavlefshmëritë e akteve administrative apo procedurale që lidhen me kërkesat për kandidatin Kreshnik Hajdari për shkak se është dënuar në shtetin Grek, është i dënuar penalisht, ne e vlerësojmë se vet Koalicioni Bashkë Fitojmë e ka filluar procedurën administrative të verifikimit të të dhënave pranë Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve dhe me vendimin nr. 315, të datës 12.04.2023 ka vendosur vijimin e verifikimit të thelluar të figurës dhe dërgimin e të dhënave përkatëse në Prokurorinë e Përgjithshme për verifikim të mëtejshëm. Ç' do lloj pretendimi i ankuesit që nuk merret në konsideratë nga KAS-i e fton KAS-in që të hyjë në kompetencat e një organi tjetër që në vlerësimin tonë nuk mund ta bëjë dhe e ka të ndaluar me ligj. Edhe në këtë kontekst kjo kërkesë është sërish abuzive, pasi vet koalicioni e ka filluar një verifikim dhe ndërkohë pa mbaruar verifikimi kërkon dhe verifikime nga KAS-i. Theksoj se e kërkon nga KAS-i në bazë të dokumentave që i ka siguruar vet ai dhe janë dokumente të tillë që i jepen vetëm kërkuarit personalisht ose ndonjë të autorizuarit me prokurë dhe jo personave të tjerë. Prandaj edhe Ligji për Dekriminalizimin ju bë pengesë ligjit nr. 138, të vitit 2015 që parashkon verifikim dhe jo konstatim. Pra ka një dokument patjetër dhe kërkon të bëjë verifikim të thelluar. Në këtë kuptim ky pretendim duhet të rrëzohet si i pabazuar në ligj dhe në prova dhe që nuk lidhet aspak me paligjshmërinë e zgjedhjeve në një qendër apo në disa qendra të caktuara të votimit. Për sa i përket edhe përkueshmërisë së pretendimeve unë ndodhem përpara një fakti në mendimin tim interesant për sa i përket heqjes dorë nga kërkimi për konstatimin e pavlefshmërisë dhe nenit të KQZ-së (*nuk kuptohet qartë*) sekretarit të KZAZ-së nr.

*Zbardhi materialin audio
Arlinda BAHOLLARI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.13.06.2023*

64 Kuçovë, Romeo Harizi. Ankuesi e ka bërë këtë kërkesë dhe hoqi dorë kur u vu në dijeni të provave që tregojnë krejtësisht të kundërtën e pretendimit. Jemi para një rasti ku pala ngre një pretendim pa asnjë lloj indicje dhe vetëm kërkon prova të cilat ne i kemi parë edhe këto në process, që kanë vërtetuar të kundërtën e pretendimit të tyre, siç ishte dhe rasti i fletëve të procesverbalit të dalë nga një video e kompozuar në atë mënyrë që ishte kompozuar, për ne ishte e papranueshme. Ky ishte një shembull që të gjitha pretendimet kanë karakter tërësisht deklarativ. Për sa i përket pretendimeve për shtyrje të numërimit të votimit në KZAZ edhe kjo kërkesë besoj se është edhe e pargumentuar, e pabazuar në prova, pasi kryetari i KZAZ-së erdhi, u thirr nga KAS si dëshmitar, dha sqarime të mjaftuedshme në lidhje me faktin, në lidhje me pavlefshmërinë e rreth 3000 (tre mijë) votave. Pasi nuk kuptohet se ku është vendosur shënimi i emrit të kandidatit, kështu është shënuar në ankim, edhe për shkak të bojës së holluar, edhe këtu dëshmitari, kryetari i KZAZ-së dha sqarime, megjithatë duhet të theksojmë edhe diçka, që ankuesit i është dhënë e drejta, pra ju vunë ne dispozicion të gjitha kamerat e tavolinave nga ku ai kishte mundësinë që të paktën të printonte disa nga fletët e votimit siç ka ndodhur me praktikat e mëparshme, që të krijonte një indicje. Ankuesi e kishte këtë mundësi. Mesa pamë edhe ne në këtë proces ka përzgjedhur disa momente të tjera dhe jo të na paraqesë fletët e votimit me parregullsitë sikurse pretendohet. Ai i ka patur të gjitha mundësitë. Për sa i përket pretendimeve të tjera për votimin nga shtetas shqiptar, të cilët sipas të dhënave të ankuesit ndodheshin jashtë Shqipërisë ne kemi dhënë shpjegime të mjaftueshme me këtë rast dhe vlerësojmë që nuk ka asnjë lloj arsyeje apo argumenti juridik në pranueshmërinë për pavlefshmëri të zgjedhjeve që bazohet në këtë pretendim. Duhet të theksoj dhe diçka, që kalimin e paligjshëm të kufirit Kodi Penal e konsideron si kundravajtje administrative dhe nuk përfshihet as nga ligji 138 i vitit 2015, nuk përfshihet në veprat penale në rrethin e atyre veprave penale që sjellin heqjen e së

*Zbardhi materialin audio
Arlinda BAHOLLARI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.13.06.2023*

drejtës së votës, pra siku ata të ishin dënuar me vendim të formës së prerë. Gjithsesi për sa i përket pretendimeve të tjera për asfaltin elektoral, organizime festive apo shpërndarje të ndihmave ushqimore, duke konsideruar kërkesat që parashtron dhe kërkon në mënyrë ekskluzive, eksplicite neni 160 i Kodit Zgjedhor dhe 1602, pika 3 që kërkon pastaj argumentimin e tyre. Ne mendojmë që janë shkelje që edhe sikur të provoheshin sit të vërteta, ato kanë ndodhur në kohë dhe në vende të ndryshme nga çfarë parashikon ligji që është qendra e votimit, pra shkeljet e ligjit që ndodhin në qendrën e votimit. Për sa i përket votimeve në grupe apo votimeve familjare ne i pamë disa video dhe vlerësojmë që sasia dhe përmbajtja e tyre nuk krijojnë dyshim për të menduar se kishim të bëjmë me një votim në kundërshtim me ligjin në atë masë që procesi zgjedhor në qendrën e votimit të shpallej i pavlefshëm sipas pretendimit të palës. Pretendimeve të tjera në lidhje me procesverbalet original apo fotokopje besoj se janë sqaruar në mënyrë shtëruese të nderuar në këtë proces. Ne kërkojmë lënien në fuqi të vendimit nr. 101, dt. 16.05.2023 të KZAZ-së nr. 64, për miratimit të tabelës përmbledhëse të rezultatit për Kryetarin e Bashkisë Kuçovë. Faleminderit!

Z. A. Llangozi, avokat: Përderisa ju dëgjuam gjatë gjithë kohës, mundet të bëj dy prapësime se më thatë kur të bëjmë konkluzjonet do të japësh dhe prapësimet në lidhje me palët.

Z. K. Bele: Ju mbajtët konkluzjonet tuaja ai mbajti konkluzionet e veta.

Z. L. Maliqi, kandidat i BF-së: Debati është sepse ai mbajti qendrim, tani unë kërkoja më parë, nëse i referohemi procesverbaleve 2 prapësime të vogla mendoj më takojnë. Në lidhje me verifikimin që pretendohet me atë vendimin e famshëm që

*Zbardhi materialin audio
Arlinda BAHOLLARI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.13.06.2023*

keni ngritur si problem, që KQZ-ja e ka zhdukur, ne kemi të bëjmë kur vetë institucioni kërkon verifikim të thelluar. Kur institucioni kërkon hetim të thelluar, ose më sakt kur nuk ka informacione, institucioni i KQZ-së i kërkon informacion, verifikime të thelluara Prokurorisë së Përgjithshme. Në rastin aktual nuk jemi para këtij fakti për dy arsye. E para është se kjo kërkesë ankimore është ngritur nga ana jonë dhe barra e provës na përket ne që ta provojmë. Se si e kemi marrë ne, me prokurë, pa prokurë, ky është një veprim që na takon ne. Vendimet penale janë vendime publike në disa vende dhe vendime jo publike në disa vende të tjera. Përshembull marrim rastin e Zvicrës, i ka vendimet penale jopublike, mbrohen nga të dhënat personale ndërsa në Greqi këto janë vendime publike ku ka akses kushdo, përveç institucioneve të Shtetit Shqiptar, të cilët i zvarrisin këto procedura. Siç e theksova, pika e parë është një kërkesë që ne e kemi ngritur dhe na takon ne mënyra e të provuarit, të cilën ne e kemi provuar e para dhe e dyta ne nuk kemi kërkuar hetim të thelluar, ne kemi kërkuar pëpara këtij institucioni që ne të konstatojmë pavlefshmërinë e veprimit juridik. Ne e kemi provuar të kundërtën e veprimit juridik të zotit Kreshmi. Është njësoj si ajo prokura që do të më kishte lëshuar mua zoti Lefter pa firmë ,pa vulë e njëjta gjë është, është zero. Ka gënjyer në atë formular vetëdeklarimi dhe duhet të konstatohet, qoftë dhe kryesisht dhe jo më me kërkesë nga palët. Pra kjo për sa i përket vendimit. Dy arsye që ne kundërshtojmë.....

*Zbardhi materialin audio
Arlinda BAHOLLARI*


*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.13.06.2023*

Z. A. Llagnozi: E para është që e kemi ngritur ne kërkesën e provojmë ne dhe e dyta është që kemi të bëjmë me një rast tjetër... edhe ajo që është më e rëndësishme është se ju nuk mund të devijoni dot nga vendimi i “Gjykatës Apelit” është lënë detyrë që ky vendim do apo s’do Kreshnik Hajdari apo kush do tjetër do të gjykohet sepse është vendim gjykate dhe duhet të zbatohet. Nëse ne, nuk arrijmë të respektojmë vendimet e gjykates atëherë s’jemi shtet “demokratik”, qoftë edhe nga ju si kolegji, është lënë detyrë nuk diskutojmë dot vendimin e një gjykate të formës së prerë, është lënë detyrë dhe kaq. Në lidhje me faktin tjetër u pretendua se kjo është një kundravajtje në Kodin Penal Shqipëtar, këtu nuk po diskujomë që Kreshnik Hajdari plotëson kriteret apo nuk i plotëson për të qenë kandidat. Nëse ai, do ta kishte deklaruar në formularin e dekriminalizimit llogjikën që ky shtetas do të kandidonte, por në rastin aktual që ai nuk e ka deklaruar ka penges sepse ka të bëjë me një formular të vetëdeklarimi të këtij shtetasi një veprim juridik absolutisht të pavlefshëm që ka pasoj të gjithë atë pjesën tjetër që ne kemi parë këtu përpara jush, pra këto për sa i përket shtetasit Kreshnik Hajdari, në lidhje me procesverbalet ne, i qëndrojmë sërish. Procesverbalet janë totalisht të falsifikuara përderisa nuk kanë qenë...

Z. K. Bele: Avokat nëse keni një prapësim që për ju, ishte e rëndësishme... foli edhe pala tjetër ne spo bëjmë dialog këtu.

Z. A. Llagnozi: Procesverbali është i falsifikuar sepse na doli këtu që paska qënë perëndia dhe erdhi foli zoti Shushari përpara nesh dhe ne, do t’i marrim të mirqëna, që nga momenti që zoti Shushari ka...

*Zbardhi materialin audio
Jonida KOCAQI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.13.06.2023*

Z. I. Rusmali: Të gjitha këto që po thua tani i the kur the pretendimet përfundimtare, menduam se do të thoje diçka që do të kishte lindur si frymzim, ne e dëgjuam herën e parë e fiksuam herën e parë po dy herë nuk ka kuptim.

Z. L. Braho: Prapësime të konkluzioneve nuk ka, ka konkluzione dhe mbaron aty.

Z. A. Llagnozi: Po ja këtë të videos për shëmbull se kisha se tha...

Z. L. Braho: Po mirë pse e harrove ti dhe e citoi ai...

Z. A. Llagnozi: Se ka mbajtur qendrimin pra, ne e kemi pritur kaq kohë ta bënim kontradiktor këtë proces po su bë, po tani duhet ta kishit bërë ju se për këtë duhet ta kishit bërë, në lidhje me pamjet filmike që pretendohet se nuk ka shkelje jo ka shkelje po ka pafund, nëse do avokati t'i marri pamjet filmike ashtu siç imorëm ne, t'i shikojë me vëmëndje.

Z. K. Bele: Faleminderit, përfundimisht për KQZ-në qëndrimi i Sekretarit të Përgjithshëm.

Z. Y. Merkaç: Rrëzimin e kërkesës si të pabazuar në ligje dhe në prova, edhe në disa raste edhe e drejta e palës ka qenë abuzive pasi kanë sjellë fakte dhe prova të pavërteta siç është mosfunksionimi i pajisjes PEI, tek qendra e votimit 3417, për këtë arsye kërkojmë rrëzimin e kërkesës, faleminderit.

*Zbardhi materialin audio
Jonida KOCAQI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.13.06.2023*

Z. L. Maliqi: Mund të them diçka pasi më frymëzuan të dy këta, më frymëzuan jashtë mase, meqënëse kerkojnë rrëzimin këta le të rrëzohet. Atëherë, në pamjet filmike ne kemi nxjerrë të paktën 1000 veprime, votime në grup, ma thoni ju të dy bashkëpunëtorët e majtë. Ku është e përcaktuar kjo në Kod? Ose ma thoni ju të mençurit, ku ka ndodhur kjo në Shqipëri që në 11:20, pa filluar procesi i rinumërimit të iki KZAZ-ja për tu larë e për tu shpëlarë, për tu tharë për 30 minuta? Ose ma thoni ju, ku është parë në një KZAZqë të ketë një derë pa u kapur nga kamerat e sigurisë, 17 kuti, 18 kuti të fletëve të votimit me tre dyer të dalë jashtë? Ma thoni ju, meqënëse jeni të zgjuar kur kjo firmë oligarke e tëmerrshme, hedh asfalt mbi asfalt çakull 24 km rrugë e me rradhë duke ndihmuar kandidatin tjetër. Si nuk favorizoka në votë kjo?

Z. K. Bele: Të lutem, të përfundojmë procesin, faleminderit. KAS mbasi dëgjoi konkluzionet e palëve tërhiqet për vendim, do t'ju thërrasim lidhur me vendimin tonë, një moment të konsultohemi, ne do të konsultohemi këtu mbasi kemi problem kourumi ditën e nesërme, edhe në rast se do të arrijmë do të japim vendimin, ju thërrasim shkurtimisht. Nëse nuk arrijmë dot do t'ju njoftojmë që mos të prisni në mënyrë të paarsyeshme...

Riçelim seancën

Ora 20:55

Riçelim seancën KAS mbasi e diskutojë çështjen në tërsi mbështetur në nenin 21 shkronja "c" dhe nenin 143 pika 1 shkronja "d" të ligjit 1019, datë 29.12.2008 i Kodit Zgjedhor, i ndryshuar KAS me shumicë votash, vendosi:

*Zbardhi materialin audio
Jonida KOCAQI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.13.06.2023*

- Rrëzimin e kërkesës ankimore numër 67 datë 20.05.2023, të paraqitur nga subjekti zgjedhor Koalicioni Bashkë Fitojmë,
 - Rrëzimin e kërkesës ankimore numër 74 datë 22.05.2023, të paraqitur nga zoti Lefter Maliqi kandidat i Koalicionit Bashkë Fitojmë për kryetar Bashkie Kuçovë.
 - Lënien në fuqi të vendimit numër 101 datë 16.05.2023, të KZAZ-së numër 64 Qarku Berat, për miratimin e tabelës përmbledhëse rezultati për zgjedhjen e kryetarit të Bashkisë Kuçovë.
 - Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, bazuar në pikën1 të nenit 145 të Kodit Zgjedhor.
 - Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Kolegjin Zgjedhor Gjyqësor pranë gjykatës Administrative të Apelit brenda 5 ditëve nga shpallja e tij.
- U shpall sot në datë 13.06.2023, me kaq seanca deklarohet e mbyllur.

Vendimi nr. 178

*Zbardhi materialin audio
Jonida KOCAQI*

